

Procesverbal

Nga Mbledhja IV (e katërt) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë: 30.04.2024

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara (mbledhja II dhe III);
2. Raporti për Realizimin e Buxhetit për perudhën Janar-Mars 2024;
3. Propozim-vendim për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionerëve 01.Nr.060/01-3947/22/3 të datës 10.03.2022;
4. Propozim-vendim për inicimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal; dhe
5. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje kryetar, përshëndetje anëtarë të Kuvendit! Përshëndetje të gjithë të pranishmëve që gjendeni në sallë! Mirë se keni ardhë në seancën e katërt të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2024! Materialin besoj se e keni pranuar të gjithë. I kemi pesë pika të rendit të ditës, mirëpo dje në KPF kemi vendosur që t'i rekomandojmë Kuvendit të Komunës edhe dy pika të rendit të ditës, pasi që Ministria e Financave n aka obliguar që t'i qesim në Kuvend këto vendime, në mënyrë që mos të na humbin mjetet financiare. Shumica e komunave kanë thirrë seancë të jashtëzakonshme për këto pika, mirëpo pasi që neve na ka ardhë njoftimi pasi që e kemi caktuar seancën, atëherë mund t'i shqyrtojmë në këtë seancë këto pika të rendit të ditës. Andaj, rekomandimet e KPF-së për Kuvend, që të futen në rend të ditës, janë: Vendimi për tejkalimin e mjeteve vetanake të buxhetuara në vitin 2023 dhe të barten në vitin 2024; dhe Vendimi për rialokimin e mjeteve të buxhetit për vitin 2024. Atëherë, nëse dikush ka diçka me shtue rreth rendit të ditës, urdhëroni!

Nexhat Selaj: Faleminderit, kryesuese! Përshëndetje për kryetarin, kolegë asambleistë e ju media! Tek rendi i ditës, kryesuese: Në seancën e fundit i tërhoqe vërejtje kryetarit dhe u deklarove se pika shtesë, përpos vendimet të cilat merren, nuk do të pranojmë. Jo se jemi kundër këtyre dy pikave të bartjes së buxhetit nga e kaluara në këtë vit, por këto po përsëriten thujse në çdo seancë. Kështu që, mënyra se si po sillen këto, gjithmonë po e gjeni një arsye, jo na lajmëruan me vonesë, jo nuk ditëm. Unë nuk mund të pranoj që këto dy pika sot të hyjnë në votim. Në seancën e radhës, besoj se do ta mbështesim fuqimisht, pasi që bëhet fjalë për bartjen e mjeteve nga viti paraprak. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdir: Faleminderit. Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Shpreh bindshëm pakënaqësinë time çdo javë që nuk na e dorëzoni materialin gjatë seancës, ose një orë para seancës, apo vetë një ditë para seancës, ndaj e mbështes propozimin e zotit Selaj. Mendoj se kjo pikë nuk është aspak e rëndësishme, mund ta bëni në një nga seancat e radhës, por ajo që dua të shtoj zonja kryesuese është se komuna jonë është në regjistrim popullsis. Ne kemi formuar një komision regjistrimi, kemi mbikëqyrës, kemi regjistruer, por ne delegatët në kuvend nuk kemi absolutisht asnjë informacion se si po bëhet regjistrimi. Prandaj po ju lus që regjistrimi i popullsisë të vihet në rend dite, të futet në fletëvotim dhe komisioni të na shpjegojë se si është gjendja jonë në terren, faleminderit.

Driton Ademi: Përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë kolegët! Atëherë, ne si grup parlamentar kemi menduar që sot me e fut një pikë të re të rendit të ditës: Siguria në trafik. Është mirë për me e diskutue. Siç ndoshta është edhe i njoftuar kryetari, para ca ditëve ka pas një aksident në Bresanë, por edhe muajin e kaluar ka pas aksident në rrugën Bresanë-Zaplluxhe. Unë po besoj se është shumë më me rëndësi kjo pikë me u fut në rend të ditës, edhe me e gjet një zgjidhje nëpërmjet kryetarit. Unë kam kërkuar edhe në seancën e kaluar që kjo çështje të merret pak më seriozisht, nëpër ato rrugë të shtrohet ose policë të vdekur ose diçka që është ma e nevojshme për qytetarët, për shkak se shumë po ka probleme me shpejtësinë në komunikacion. Ne si grup parlamentar kërkojmë që të futet edhe një pikë e re e rendit të ditës, siguria në trafik. Faleminderit!

Uran Halimi: Përshëndetje të pranishëm! Po flas në lidhje me pikat e rendit të ditës, që vazhdimisht me këni akuzue edhe në kohën kur unë isha kryesues. Futjen e këtyre pikave për një kohë kaq të shkurtë, me materiale, këto dy pikat të cilat i ceku kryesuesja, kanë ardhë dje në Komitet, bile rrugës t'u ardhë për në Komitet. Ju kuptoj, keni qenë vazhdimisht kundër, kam qenë i obliguar edhe unë me u marrë me këtë çështje edhe me i paraqit si pika të reja të rendit të ditës. Mirëpo, kjo nuk është në të mirën tonë, se jemi të papërgatitur në lidhje me këtë. Andaj, është mirë që kur të vjen rendi i ditës, me iu përmbajt atij rendi të ditës i cili na është servu, dokumentacioni që na është servu, në mënyrë që edhe seanca të shkojë në mënyrë të duhur. Faleminderit shumë!

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, zv/kryesues, të nderuar delegatë, mjete të informimit, ju përshëndes të gjithëve! Dje KPF-ja i ka aprovue me shumicë votash propozimin tim për futjen në rend të ditës në seancën e katërt të rregullt të Asamblesë Komunale këto dy pika të rendit të ditës. Unë dje e kam dhënë sqarimin dhe anëtarët e KPF-së e kanë pranue këtë sqarim. Unë po jua bëj edhe juve. Në seancën e kaluar ne kemi pru Vendim për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti i kaluar, si dhe tejkalimin e grumbullimit të mjeteve vetanake. Mirëpo, Ministria e Financave nuk e ka bërë bartjen e këtyre mjeteve sipas Vendimit të Asamblesë Komunale, por ato mjete i ka bart në ato projekte të cilat kanë qenë të miratuara vitin e kaluar, në projekte të cilat ose janë përfundue, ose më nuk janë

prioritet në këtë vit. Kështu që, njoftimin për bartjen e këtyre mjeteve ne e kemi marrë pasi e kemi çue materialin për seancën e rregullt të katërt të Asamblesë Komunale. Komunat tjera në nivel të Kosovës – edhe Prizreni – kanë thirrë seancë të jashtëzakonshme për këto pika edhe ata i kanë miratue. Mirëpo, ne masi tri ditë më herët na ka ardhë ky njoftim, nuk kemi pas nevojë me thirrë seancë të jashtëzakonshme dhe kemi dashtë që ta shfrytëzojmë këtë seancë, që këto dy pika të miratohen, në mënyrë që MF-ja të na bëjë alokimin e këtyre mjeteve në projekte të cilat janë të parapara të realizohen këtë vit. Nuk është gabim nëse këtë e bëjmë, për arsye se nëse ne i lëmë këto dy pika t'i shqyrtojmë në seancën e ardhshme, ne vetëm e humbim më shumë se një muaj edhe kurgjo tjetër nuk bëjmë. Është fjala për projekte kapitale dhe, për ne në Komunën e Dragashit koha është ari, duke marrë parasysh se edhe pranvera këtu vjen ma vonë, edhe dimri vjen më herët. Periudha e punëve në Komunën tonë nuk është si në Prizren, ku mund të punohet nga janari deri në dhjetor. Këtu po fillohen punimet nga fundi i prillit dhe në nëntor po përfundojnë. Kështu që, i kisha lut delegatët me mirëkuptim, që ta pranojnë këtë propozimin tim dhe arsyetimin. Edhe këto pikat që u propozuan, regjistrimi i popullsisë është shumë me rëndësi, edhe siguria në trafik është me rëndësi. Të gjitha këto pika të futen në rend të ditës dhe të diskutohen. Faleminderit!

Munir Jonuzi: Të nderuar të pranishëm, që në fillim të kësaj seance kemi disa pika në rend dite, një nga ato pika është edhe ky vendim që presidenti thotë se ka ardhur nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Unë do të kërkoja për hir të drejtësisë, për hir të së vërtetës, t'i shikojmë ato vendime, të na japin një pushim prej pesë minutash, të na i dorëzojnë ato vendime dhe të shohim pse Ministria e Financave po i devijon ato fonde nga disa projekte të papërfunduara, të cilat duhet të kishin përfunduar vitin e kaluar, deri tek disa projekte të reja. Për propozimin e dytë, kolegu Nejamidin paraqiti një propozim, një çështje e rëndësishme, një ngjarje aktuale. Mendoj se të gjithë duhet ta përkrahim një propozim të tillë, përfshirjen e regjistrimit aktual të popullsisë, që agjencia komunale e regjistrimit të na sqarojë disa gjëra, jo neve sa regjistruesve, sa mbikëqyrësve, por qytetarëve të kësaj komuna, sa i përket asaj se çfarë duhet të bëjnë. Dhe ne kemi edhe një propozim të tretë për trafikun, nëse është gjithashtu një propozim shumë aktual dhe i rëndësishëm, atëherë edhe unë e mbështes atë propozim.

Shpetim Hajredini: Faleminderit, e nderuar kryesuese! Përshëndetje i nderuar kryetar, të nderuar drejtorë, kolegë e kolege asambleistë, qytetarë të nderuar të Dragashit, ju përshëndes të gjithëve! Deshta edhe unë pak të ndërlihem me këtë problemin e këtyre dy pikave, e cila u hap në këtë seancë. Ajo pyetja dhe ai konstatim i imi i para disa seancave që e pata bo unë, se dërgimi i materialit në formë elektronike nuk është shumë në rregull, pasi që është një pjesë e madhe e kolegëve, siç po shihet edhe sot, as që e kanë lexue materialin e këtyre dy pikave të cilat na kanë ardhur dje. I nderuar drejtor i Administratës, unë ta pata kërkuar dy herë radhazi që materiali të na vjen edhe fizikisht. Por, një gjë e

tillë nuk ka ndodhur, edhe po e shoh këtu se mbi 50% e kolegëve të mi janë të papërgatitur dhe nuk i lexojnë materialet të cilat na vijnë në formë elektronike. E, hala më keq kjo që na ka ardhur sot, një ditë para mbajtjes së seancës, realisht ta them edhe unë nuk e kam lexue. Në mbrëmje më kanë thirrë që ka ardhë edhe një material shtesë. Për mu nuk është diçka absurde, se ai material është shumë i thjeshtë dhe e kuptoj, edhe nuk po më prish punë mu sot që ta diskutoj, për shembull, kur ta kemi në pikën e pestë apo të gjashtë. Por, për disa është jo e kapshme. Prandaj, unë kisha kërkuar, i nderuar drejtor i Administratës, që së paku në seancat e ardhshme ta kemi materialin edhe në formë fizike. Nëse është e mundur, në të kundërtën detyrohem që ta bëj si propozim. Dhe, nëse atëherë nuk e kam mbështetjen prej kolegëve të mi, vazhdo. Për mu fare nuk paraqet problem, se unë përgatitem edhe në formë fizike, edhe në formë elektronike dhe nuk më çon problem. Ju falemnderit!

Vetim Ramadani: Falemnderit, kryesuese! I nderuar zv/kryesues, kryetar, delegatë, qytetarë që po na ndjekin! Unë po e kuptoj shqetësimin tënd, Shpetim. Mirëpo, vitin e kaluar, nëse ju kujtohet, kur kemi pas diskutim për furnizimin me lloptopë të gjithë delegatëve, ne të gjithë kemi rënë dakord që materiali të dërgohet online, me qëllimin e vetëm që të mos kemi probleme edhe nga ana teknike e administratës për me e përgatit – meqenëse është dashtë jashtëzakonisht kopje të bëhen, kemi seanca kur nuk kemi pas edhe aftësi teknike të printerëve, me e printue të gjithë materialin – e nga ana tjetër edhe në sajë të kuptimit të shfrytëzimit sa më ekologjik edhe sa më pak të letrës. Pra, këto kanë qenë dy pikat kryesore që Asambleja ka vendos që të ndodhë një gjë e tillë. Për këtë dëshmi janë kontratat apo procesverbalet e pranimit, të cilët i posedoni të gjithë nga ju që jeni frunizuar me lloptopë. Njëri ndër nenet e asaj kontrate apo marrëveshje shënon shumë qartë që ju do ta pranoni materialin e seancës në mënyrë elektronike. Përndryshe, për çdo ndryshim të mundshëm, Drejtorja e Administratës është e gatshme që të ballafaqohet me të gjitha kërkesat tuaja që vijnë nga Asambleja Komunale. Por për këtë duhet të jeni të gjithë dakord edhe ta kemi një qëllim të përbashkët. Edhe pse – unë nuk mendoj – nuk më takon të komentoj edhe atë që e tha ti, sa i përket të gjithë kolegëve tuaj. Unë me sa e di, të gjithë asambleistët, edhe kur e kanë marrë materialin në mënyrë fizike, edhe tash elektronike, pak a shumë, ata të cilët kanë interes, kanë të drejtë në qasje, madje është edhe më lehtë se e ka lloptopin me vete në seancë, e hap lloptopin edhe e shfleton të gjithë materialin. Edhe, opsioni tjetër është “search it” edhe “find it”, secilën pjesë të diskutimit mund ta gjesht aty. Unë besoj që është më e lehtë, sidomos kur trendit është t’u shkue në përmirësim të teknologjisë dhe avancimit të tyre, e jo të kthehemi ne tani në kopje fizike. Por, sido që të jetë qëndrimi i Asamblesë, unë jam i gatshëm që ta zbatoj, por duhet të kemi parasysh se pjesë e artyre kontratave është edhe furnizimi me material përmes lloptopit, në formë elektronike, jo në formë fizike. Nuk është problemi tek Drejtorja e Administratës. Falemnderit!

Driton Ademi: Atëherë, ne e kemi lexuar kontratën, drejtor, siç po thua ti që e kemi nënshkruar, por unë sot po propozoj – masi po thuesh edhe munden me qenë materiali shumë voluminoz – unë po

propozoj sot që procesverbalet mos me na dërgue në kopje fizike, se e di që ka harxhim ma shumë, por vetëm pikat e rendit të ditës nuk ju kushton shumë për me i dërgue. Po e qes si propozim, domethënë, me na dërgue materialin në kopje fizike, vetëm me pikat e rendit të ditës, pa procesverbalin, se e di që procesverbali është shumë i gjerë edhe s'besoj që kush e lexon – nëse do dikush munden me e lexue. Po edhe një problem, neve nuk është t'u na punue edhe këtu internet, se po duhet me e çue përmes telefonit për me e lidhë, lloptopat për me i marrë këtu në seancë. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Faleminderit zonja Presidente, e kuptoj drejtorin e administratës, e kuptoj qeverinë dhe gjithçka në përgjithësi, megjithatë, kur na i keni dorëzuar laptopët, duhet të kishit krijuar kushtet në këtë sallë, që diskutimi. nga vendi mund të zhvillohej pa pengesë. Tani, që secili prej nesh delegatët të mos mbajë një laptop këtu pas podiumit, jam dakord me ju, nuk kemi nevojë për materiale në formë fizike, por ju duhet të na siguron kushtet, që ne të kemi. mikrofonta të vendosura në stola dhe që mund t'i diskutojmë nga vendi, në të njëjtën mënyrë siç ka punuar kryetari ynë i dashur prej këtu pak kohë më parë. Kemi dy variante, ose do vendosni mikrofonta vende-vende, do beni kabina elektronike, ku ne delegatet do hyni me karta, do e fikni energjinë nga ku jeni, nese gabojme, ose do jepni materiale. në formë fizike tek ne mund të kemi atë për të cilën po flasim para nesh këtu në tribunë. Duhet ta pranoni se është pak e vrazhdë, pak e çuditshme dhe e vështirë, që po e tërheq zvarrë laptopin tim këtu çdo dy minuta. Ju lus që të respektoni dinjitetin e këtij kuvendi, sepse aktualisht jemi duke diskutuar për formimin e rendit të ditës, kur të formohet rendi i ditës, të drejtën e fjalës e ka kuvendi dhe kryetari i komunës, por jo drejtorët. faleminderit.

Shpetim Hajredini: I nderuar drejtor, ne lloptopat i kemi pas edhe para ardhjes suaj në ekzekutiv, edhe e kemi pas kontratën dhe e kemi lexue, e kemi ditë që e kanë mundësinë të na dërgojnë vetëm në formë online edhe të mos na dërgojnë materialin në formë fizike, mirëpo ata e kanë kërkuë prapë në formë fizike, se ne e kemi kërkuë një gjë të tillë. Kështu që, arsyetimet të cilat ti i dha, nuk çon problem për mu, ta thashë, absolutisht aspak. E dërgove në formë elektronike apo fizike, për mu nuk çon peshë. Si do që ta dërgon, unë përgatitem dhe s'e kam fare atë problem. Mirëpo, unë po e shoh që një shumicë e madhe qetu prej kolegëve të mi nuk janë të përgatitur. Aspak, ta them përmi 70-80% nuk i kanë lexue dy pikat e fundit që i keni dërgue dje. Kjo është esenca e asaj që unë e thashë më herët. Gjithashtu, duhet të lidhem pak edhe me kolegun tim, Nedžmidin Sejdilar, që tha nuk i kemi kushtet për të marrë lloptopin edhe për të diskutue. Këtë e kam thënë qysh në seancën e parë kur keni vendos të na dërgoni materialin në formë elektronike, që po ta kemi mundësinë e diskutimit me lloptopë, absolutisht është krejt në rregull. Mirëpo, lloptopin ta marr këtu ta vendosi tash dhe të diskutoj është bajagi problem, e zorshme është prej këtu ta marr me veti. Nëse e ke mundësinë, edhe një vit e ke një qeverisje më tepër, që ke mundësi me na i sigurie mikrofonat te vendi, po i marrim atëherë lloptopat me veti, po e diskutojmë edhe nuk keni nevojë atëherë me na dërgue materialin në formë fizike. E fundit e jemja

është, edhe një herë, nuk muj unë me të detyrue me na dërgue materialin në formë fizike, se tek e fundit ju jeni ata të cilët e merrni një vendim të tillë. Për mu, vendosni çka të doni ju me bo, ai dërgoni në formë fizike apo elektronike, nuk çon peshë. Por për një pjesë të mirë të kolegëve të mi, kish qenë mirë ta dërgoni në formë fizike. Ju faleminderit!

Arijeta Skeraj: Para se me e marrë Urani fjalën, deshta z.Sejdilar, në rend të ditës e di që anëtarët e Kuvendit duhet të marrin fjalën për këtë pikë, por edhe ti ishe në sallë që z.Shpetim Hajredini e përmendi drejtorin e Administratës dhe unë për atë ia dhashë fjalën, që të dalë me një sqarim. Të lutem, unë i di rregullat. Të gjithë jemi në sallë, të gjithë e dimë që Shpetim Hajredini e deshti fjalën nga drejtori i Administratës. Faleminderit!

Uran Halimi: Po kthehemi prapë te rendi i ditës për pak, se devijoi tema e debatit. Ishte fjalë për futjen në rend të ditës pika për bartjen e mjeteve të pashfrytëzuara. Ne nuk jemi për mos me i bart ato mjete, mirëpo problemi është që rialokimi i këtyre mjeteve është bërë pa pëlqimin tonë. Ne kemi votue më herët një buxhet me destinime të këtij lloji, për shembull e kemi te pika e dytë (Asfaltimi i rrugës për bjeshkë në fshatin Kuk) këto mjete që kanë mbet të pashfrytëzume, këto nuk po barten ose nuk po shkojnë prapë te rruga e bjeshkës së fshatit Kuk, po ia kanë ndërrue destinacionin. Vendet të cilat më së shumti po preken nga bartja e këtyre mjeteve, zakonisht janë fshatrat e komunitetit joshumicë. Të nderum delegatë, ju duhet me e ditë këtë, s'e di a jeni t'u e pa që... unë po flas për këto pika, kjo qështë pika që duhet me e diskutue, jo për atë materialin e seancës, ses'patëm propozim për atë, po erdh në ndërkohë. Kjo është pika dje që na keni servue materialin edhe na po duhet me e fut në rend të ditës. Faleminderit shumë për këshillën. Sidoqoftë, është fshati Rapçë, fshati Kuk, Zlipotok, Glloboqicë, Baçkë, Brod etj., të cilave po iu merret buxheti, në fakt ka mbet buxhet i vitit të kalum. Ndëra, për vitin paraprak ose vitin e ardhshëm po rialokohen krejt dikah tjetër. Është mungesa e mjeteve për blerjen e automjeteve për QKMF-në, vazhdimisht z.Loshaj është ankuar për ato ambulancat të cilat ecin me 40 në orë maksimumi. Edhe për ato autoambulanca që janë jashtë funksionit, e në vitin e ardhshëm nuk është paraparë blerja e këtyre ambulancave. Domethënë, e bartim një buxhet jo ku është paraparë, mbesin projekte këto të pazbatuara edhe rialokohen krejt diku tjetër. Këtu është esenca, ne nuk mundemi me i lënë këto mjete pa i bart, mirëpo rialokimi i tyre është sipas dëshirave të pushtetit. Kjo është arsyeja pse na s'duhet me e mbështet këtë pikë të rendit të ditës.

Arijeta Skeraj: Pasi pat shumë kërkesa që të futen si pikë të rendit të ditës dhe të gjithë ishin që të futen këto pika – regjistrimi i Popullsisë, për sigurinë në trafik që e përmendi Dritoni dhe për kopje fizike pa procesverbal që e përmendi shefi i GP të PDK-së. Atëherë, një propozim e pat z.Munir, që të merren pesë minuta kohë. Ju kisha lut, në qoftë se doni, pesë minuta kishim marrë kohë që këto pika të rendit të ditës t'i diskutojmë dhe për me i qit në votim. Kush ëshë pro që të marrim pesë minuta paузë? Atëherë, pas pesë minutave kthehemi në seancë! Faleminderit!

Atëherë, kuorum ka edhe po fillojmë me e vazhdue seancën.

Nedžmidin Sejdlar: Zonja Kryesuese , ju kërkoj ndjesë që duhet të largohem përsëri nga foltorja, derisa ishim në pushim, inbox-i im është plot me mesazhe që nuk kemi transmetim të drejtpërdrejtë.

Unë do t'ju kërkoja të zgjidhni çështjet teknike, qytetarët e kësaj komune nuk duhet të jene në errësirë, duhet të dinë se çfarë po diskutojmë këtu. Kërkoj që të urdhëroni mediat të transmetojnë seancën, që të mos i mbajmë qytetarët në errësirë, faleminderit.

Arijeta Skeraj: Faleminderit, z.Sejdlar! Unë nuk e di që nuk është live dhe po due që nga kryetari që të bisedojë dhe të fillojë live menjëherë! Deri sa ta marr konfirmimin, a ka mundësi me prit? Pasi që e konfirmuam që është live, atëherë po fillojmë me vazhdimin e seancës, dhe po i hedhim në votim rekomandimet e KPF-së, propozimet që ishin nga KPF-ja. Kush është pro këtyre dy propozimeve? Kush është kundër? A ka abstenim? Me 13 vota pro, 12 kundër dhe zero abstenim, miratohen këto dy propozime. Atëherë, fillojmë me propozimin e z.Sejdlar, për informatë rreth regjistrimit të Popullsisë. Kush është pro që kjo të futet si pikë e rendit të ditës? Kush është kundër? A ka abstenim? Me 25 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, edhe kjo pikë futet në rend të ditës. Vazhdojmë me propozimin e Driton Ademit, siguria në trafik. E hedhim në votim. Kush është pro këtij propozimi? A ka kundër? Abstenim? Me 25 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, edhe kjo pikë futet në rend të ditës. Shpetim Hajredini kërkoj që materiali të sillet në kopje fizike, pa procesverbal. Këtë pikë nuk do ta shtimë në rend të ditës, por do t'i iniciojmë procedurat për me u vendos mikrofonat nëpër çdo ulëse të Asamblesë. A jeni dakord që të jetë kjo më mirë, që prej vendit me folë? Do ta iniciojmë, bashkë me drejtorin e Administratës e diskutuam që kjo do të jetë mënyra më e mirë, pasi që janë marrë lloptopët. Kush është pro që kjo të bëhet? Z.Xheladini, ne i kemi marrë lloptopët dhe më e udhës është që çdo ulëse ta ketë foltoren e vet.

Driton Ademi: Unë e di që derisa të zhvillohet tenderi për me i vendos mikrofonat shkon një periudhë goxha e gjatë. Unë po mendoj që me na pru kopjet fizike vetëm me pikat e rendit të ditës, pa procesverbalin. Nga seancat e ardhshme, domethënë derisa të rregullohen mikrofonat. Vetëm me pika të rendit të ditës, pa procesverbal. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Unë e di që ne si ekzekutiv edhe ju si asambleistë nuk keni dëshirë që t'i bëni Komunës shpenzime. Ju e dini që kopja fizike, së pari harxhon tonerë, harxhon letër. Ajo çka është me rëndësi, na duhet ta sigurojmë edhe një automjet, një shofer, me ua shpërnda, nëpër shpia me ua pru. Po duhet edhe me sigurie mëditje, gjithashtu edhe shërbimi i Kuvendit po duhet me ndejt edhe mas orarit të punës me i përgatit këto. Kështu që, na lloptopët i kemi bërë me qëllim që t'i ulim shpenzimet. Edhe në këtë drejtim, besoj që edhe ju këtë e keni parasysh, por pasi që doli propozimi që deri të vendosen mikrofonat të çohen kopje fizike, atëherë është kërkesë e pranueshme.

Arijeta Skeraj: Unë kisha dashtë, masi e ka bërë kërkesën z.Shpetim Hajredini, pasi deri tash kemi ndejt pa kopje fizike dhe besoj mos po përshpejtohen procedurat, është mirë që të vazhdohet kështu, deri kur të vijë. Po e shoh të arsyeshme që, pasi ti e ke dhënë propozimin, pak me e marrë fjalën.

Shpetim Hajredini: Faleminderit, e nderuar kryesuese! Faleminderit drejtor i Administratës për këtë propozim, është shumë propozim i mirë, i arsyeshëm. Unë thashë qysh në fillim, që për mua nuk çon peshë. Pjesa dërmuese e asambleistëve janë që të vazhdojnë në këtë formë, deri në vendosjen e mikrofonave, apo nëse dojnë ta marrin propozimin e Driton Ademit, për mu është e njëjta. Unë, komplet fjalimin tim, esenca e fjalimit tim ka qenë për një pjesë të kolegëve të mi, prej të cilëve kam marrë informacione që nuk po mund të përgatiten në këtë formë. Sa më përket mua dhe një pjese që janë të ri dhe që e kuptojnë teknologjinë, nuk është problem edhe një muaj-dy. Por, këto janë procedura të tenderimit që nuk besoj që brenda - 6-7 muaj bon vaki shkon, nuk mund ta realizojnë. E fundit është dora e kolegëve të mi, le të vendosin vetë këta. I keni dy opsione, le të votojnë, nëse dëshirojnë ta mbajnë propozimin tuaj, të drejtorit të Administratës, apo propozimin tim. Lëvizi pak Dritoni, e lehtësoi për Komunën, që deri në implementimin e projektit, të na bien kopjet fizike edhe elektronike. Le të vendosin këta. Faleminderit!

Vetim Ramadani: Atëherë, një shprehje thotë: “Njeriu kur do, e gjen mënyrën, kur s’do, e gjen arsyen”. E na duhet me e gjet mënyrën, përderisa sa është kërkesë e juaja. Unë një gjë e di: ne si Komunë, unë si drejtor i Administratës, si shërbim i Kuvendit, jemi të obliguar që të deleguarve të popullit, siç është Asambleja Komunale, me ua sigurue të gjitha informatat çka ata kanë nevojë. Edhe me u sigurue që informacioni me ardhë me ju në formën e plotë. Duke u nisur prej këtij parimi, unë kisha propozue që, nëse e kam dakordimin tuaj, ne si Drejtori e Administratës t’i iniciojmë procedurat për pajisjen me mikrofon të secilës ulëse të Asamblesë. Në këtë periudhë tranzitore apo kalimtare, derisa të rregullohet ky process, ne të vazhdojmë t’i dërgojmë kopjet, mirëpo kopje fizike pa procesverbal. A jemi dakord, le ta vendosë Asambleja, edhe ne jemi të gatshëm që të ecim në këtë drejtim. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Atëherë, po e hedhim në votim. Kush është që, deri të inicohet procedura për mikrofonta, materiali të vjen në kopje fizike, pa procesverbal. A ka kundër? Abstenim? Me 23 vota pro, zero kundër dhe 1 abstenim, edhe kjo pikë miratohet. Atëherë, e hedhim në votim rendin e ditës, me të gjitha propozimet që deri tani u miratuan nga Asambleja Komunale. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 25 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet rendi i ditës. Atëherë, po fillojmë me pikën e parë. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara (mbledhja II dhe III). A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro këtyre procesverbaleve? A ka kundër? Abstenim? Me 24 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohen procesverbalet. Vazhdojmë me pikën e dytë: Raporti për Realizimin e Buxhetit për periudhën janar-mars 2024. A do dikush me e marrë fjalën?

Driton Ademi: Këtu te pika “Shpenzimet buxhetore paga dhe shtesa”, deshta me e ditë shtesat e veçanta për të zgjedhurit, qekjo çka është, nuk e kam pa te vitet e kalume. Çka është qekjo pika “Shtesat e veçanta për të zgjedhurit -13,600 euro”? Ku janë destinue këto shpenzime, s’kam njohuri për këto. Kujdestaritë, punë gjatë natës dhe punë jashtë orarit të punës – 53 mijë euro për tre muaj, me një Komunë kaq të vogël, kjo është katastrofë. Nuk e di kush ka shpenzue kujdestari kaq shumë, gjatë natës kaq shumë. Kush është t’u punue, s’besoj që përveç spitalit munden me punue dikush tjetër. Plus punë jashtë orarit, a qaq jemi ngarkesë që jemi t’u punue punë jashtë orarit? Pagesat e vendimeve gjyqësore. Vitet e kaluara neve na keni akuzue për qeto vendimet gjyqësore, kurse ju këtë vit keni bo pagesa të vendimeve gjyqësore 113 mijë euro. Besoj, këto pagesat e vendimeve gjyqësore, drejtori i Administratës duhet me na dhënë një sqarim. Ndoshta janë të pagava, a dikujt të arsimit. Te pagat dhe shtesat, pika 10 është, nëse e ke kopjen fizike. Shtesat e veçanta për të zgjedhurit – 13 mijë euro. Te pyetja 12 – Kujdestari, punë gjatë natës dhe punë jashtë orarit të punës. Pagesat e vendimeve gjyqësore. Dalim te mallrat dhe shërbimet: Shpenzimet e udhëtimit në vend, në krahasim me vitin e kaluar, është një rritje shumë e madhe, nga viti 2023 në 2024, për tremujorin e parë – 38 mijë euro. 30 mijë euro janë më shumë të shpenzuara. Shërbimet e veçanta – 55 mijë euro, asnjërin vit nuk kemi pas shërbime të veçanta, çka është kjo pjesa e shërbimeve të veçanta? Unë me sa e kam pa – nuk e di këtu në Dragash, nuk kam qenë – po naftë për ngrohje qendrore. Ngrohje qendrore ju çon ambulanteve, QKMF-ve e qetyne, po me sa e kam pa unë, në Bresanë nuk ka pas, në pjesët tjera nuk e di. Veç në tremujorin e parë me i harxhue afër 19 mijë euro naftë për ngrohje qendrore, qekjo po më vjen goxha absurde. Reklama dhe konkurse; a qaq konkurse keni pas që 4 mijë euro keni harxhue, a? Asnjërin vit nuk janë shpenzue përmi 300-400 euro. Në tremujorin e parë të vitit 2024, afër 4 mijë euro reklama dhe konkurse. Qaq shumë po kushtojnë gazetatat që po i qitni këto? Edhe te ekzekutimi i vendimeve gjyqësore – 14,951 euro. Me sa e di unë, e ka pru qeverisja një vendim për mbeturinat, për “Ekoregjonin”, por këtu te mbeturinat na nuk e di që i kemi rrit çmimet. Edhe ky u hedhë poshtë, për me ardhë në gjashtëmujorin e parë, ka pas për me ardhë ky ligj i ri. Pse mbeturinat, nga viti 2023, tremujorin e parë, kanë kalue në 23,800 euro. Domethënë, ka rritje diku afër 16 mijë euro, tremujorin e parë të 2024-tës. Një pyetje tjetër është që subvencionet për entitete jopublike, fondi 21. OVL – UÇK ia keni cek 2 mijë euro, po pse nuk e keni cek te përfituesit individualë që janë 5,900 euro, kush janë këta individë që kanë marrë, përfitues individ. A kemi të drejtë ne si Asamble Komonale me i ditë edhe këta, qoftë me iniciale ose ku janë shpërnda këto pare. Për këto pyetje kisha pas qef një sqarim. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Driton, po fillojmë prej pyetjes që e bëtë për shtesat e veçanta për të zgjedhurit. Ju e dini se me ligjin e rim bi pagat, kanë ndryshue edhe komitetet edhe funksionimi i komiteteve, dhe tash e dini se merrni edhe shuma pak më të mëdha në raport me të cilat i keni marrë. Ky kodi tash vlen pikërisht për këto komitete, që ju si delegatë jeni anëtarë të komisioneve të ndryshme. Dhe ju jeni

përfaqësues. Për të zgjedhurit, ju duhet ta dini se këtu flitet për të zgjedhurit, për organet dhe për delegatët. Nuk kemi të bëjmë me diçka tjetër. Pagesat e vendimeve gjyqësore – 113 mijë euro, janë në shëndetësi, të cilat janë deri në vitin 2021. Janë pagat jubilarë, ka edhe disa në arsim, po kryesisht janë në shëndetësi. Po mirë, këto janë shumat, edhe disa në arsim. Këto janë pagat jubilarë që i kanë marrë përmes gjyqit. Mund t'ju bina edhe specifikacionin. Qata që i kanë marrë, janë goxha të mëdhaja në shëndetësi, secili individ nga 1 mijë euro i merr. Ka edhe nga 3 – 4 mijë. Këto janë, gjashtëmujorin tjetër me siguri kanë me qenë dyfish më të mëdha, por këto janë që na nuk mundemi me i ndalë. Ju bëtë pyetje cilat janë, këto janë. Tash për secilin individ ne mund t'ju biam specifikacionin, na nuk jemi gjeni me e ditë secili sa merr. Shpenzimet e udhëtimit në vend: është e vërtetë, edhe vitin e kaluar biseduam se janë transporti i nxënësve dhe paguhet përmes këtij kodi. Sa u përket shërbimeve të veçanta: pastrimin, larjen, mirëmbajtjen – ne kemi bisedue – kontratat i kemi bo me ndërmarrjet publike që jemi t'u i krye edhe janë duke u krye këto shërbime. Nuk ka pas, se nuk keni pas të kontraktume këso punime. Dhe tash kemi dhe i paguajmë përmes këtij kodit. Karburantet për automjete: kësaj radhe edhe gjeneratorët Ministria e Financave i ka shti në të njëjtin kod. Tash paguhet prej të njëjtit kod, që marrin edhe shkollat për përdorimin e gjeneratorëve. Sa i përket reklamave dhe konkurseve, është bërë pagesa e përfaqësimit të Komunës në Panairin i cili është mbajtur më 16-18 prill në Prishtinë. Janë shtyp dhe janë botue ofertat turistike të Komunës së Dragashit, dhe panot, të cilat i kemi prezantue atje. Nëse duesh, e ke edhe në uebfaqe, janë të mbuluara shpenzimet për katër biznese të cilat kanë marrë pjesë atje. I kemi paguar panot e tyre dhe gjithashtu i kemi shtyp dia materiale që i kemi shpërndarë për këtë panair. Prandaj, kjo është shuma e përgjithshme. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore: hala nuk na kanë mbërri të 2022-tës, të jesh i bindur që janë të 2021-tës. Në qoftë se do, edhe për këtë ta bie specifikacionin. Janë shpenzime të qeverisë së mëhershme, që janë duke i marrë përmes gjyqit. Në qoftë se nuk je i bindur, mundesh me ardhë në zyrë, nuk duam me bo spektakël, po shumë sinqerisht po të them se hala nuk na ka ardhë asnjë shpenzim ose asnjë vendim gjyqësor, prej se jemi në qeverisje nga 2022-2024. Pastaj janë kujdestaritë, janë punët shtesë, ka punëtorë që kryejnë punë shtesë. Janë të gjitha ato që i bjer Zyra e Personelit dhe përmes saj shkojnë këto pagesa. Ky kod është, këto vlera janë dhe këto janë shpenzimet reale që janë krijuar. Te pagesat për përfituesit individualë: gjatë vitit të kaluar kur kemi dhënë subvencionet për fermerë, edhe disa bursa të studentëve, kanë pas probleme me llogaritë bankare dhe nuk kanë mund t'i marrin të gjitha paratë. Kështu që, i kemi rregullue ato probleme teknike dhe i kemi krye obligimet sivjet, që janë në vlerë 5,595 euro. Te mbeturinat, i kemi muajt nëntor-dhjetor dhe muajt tjerë të cilët na janë grumbullue, sepse na i kanë pru pagesat me vonesë, nuk kemi mund t'i kryejmë në vitin 2023 dhe i kemi bart në periudhën e parë të vitit 2024, janë krye këto pagesa. Nëse kam harrue diçka, të kërkoj falje!

Vetim Ramadani: Për mos me i mbet borxhe Dritonit edhe me dy pika që i përmendi. Në pozicionin 12, tek shpenzimet buxhetore Pagat dhe Shtesat, është kujdestari, punë gjatë natës dhe punë jashtë orarit të punës. Pjesa dërmuese e këtij shpenzimi gjenerohet nga kujdestaritë që mbahen në QKMF, dhe kjo vjen prej faktit që Ligji për punëtorët shëndetësorë është i atillë, që kujdestaritë paguhen në shumë goxha të larta, dhe nuk është faji ynë. Por, për të gjithë këto ka dëshmi, është raporti i kujdestarive që çdo muaj duhet të nënshkruhet nga kryetari i Komunës për zotim të mjeteve. Sa i përket pozicionit 13720 në kategorinë mallra dhe shërbime, naftë për ngrohje qendrore, ka qenë furnizim në QPS dhe në QKMF. I kam edhe raportet e pagesave. Pra, në QPS është bërë një furnizim në vlerë prej 2 mijë litër – që është i datës 25.01.2024, kam edhe raportin – edhe pagesa tjetër është furnizimi për QKMF-në, në sasi prej 12,958 litër, afërsisht 13 mijë litër, edhe ky pranim është bërë më datën 25.01.2024. Kështu që, nuk ka kurgjo diçka në kundërshtim me ligjin. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kesaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 23 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe pika e dytë. Vazhdojmë te pika e tretë: Propozim-vendim për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve 01 Nr.060/01-3947/22/3 i datës 10.03.2022. A do dikush me e marrë fjalën?

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, siç e dini, në këtë Komision, mes tjerash ka qenë edhe ish-asambleisti i LDK-së, z.Naser Myrtezan. Tash ai më nuk është asambleist, dhe për këtë arsye ne kemi marrë një vendim që të bëhet plotësimi i këtij Komisioni me anëtarë të tjerë. Gjithashtu, edhe Veton Halili, i cili ka qenë anëtar i këtij Komisioni, për shkak se është shef i Kabinetit të kryetarit, është tërheq nga përbërja e këtij Komisioni. Unë si kryetar i Komunës, i propozoj Asamblesë Komunale që në vend të Naser Myrtezanit të jetë asambleistja Ventaza Esati si pjesë e këtij Komisioni. Arsyeja është se Komisioni prej tre anëtarëve duhet të ketë së paku edhe një të komunitetit joshumicë dhe, gjithashtu, për shkak të performancës që na është kërkuar, njëri prej anëtarëve të Komisionit duhet të jetë edhe femër. Kështu që, unë propozoj që në vend të Naser Myrtezanit, si anëtare e këtij Komisioni të jetë Ventaza Esati. Gjithashtu, në vend të ekzekutivit, të anëtarëve që ka të drejtë të propozojë ekzekutivi, të jetë Brendi Berisha në vend të Veton Halilit. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kesaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 14 vota pro, zero kundër dhe 5 abstenime, edhe kjo pikë kalon. Vazhdojmë me pikën e katërt: Propozim-vendim për iniciimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032.

Qamil Kolloni: Të nderuar delegatë, ju e dini se PZhK i Komunës së Dragashit ka qenë 2013-2023 dhe, rrjedhimisht, ka skadue afati i tij. Ne kemi marrë një Vendim më herët, për krijimin e PZhK-së dhe, gjithashtu, edhe hartave zonale. Atë Vendim, për shkak të harmonizimit me Qeverinë qendrore,

kemi qenë të detyruar ta shfuqizojmë. Tash kemi mbërri në fazën kur jemi të detyruar që të bëjmë hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2024-2032. Pasi ta bëjmë miratimin e tij, neve në afatin tjetër, pas gjashtë muajsh, duhet të fillojmë të bëjmë edhe hartimin zonal. Prandaj, jemi të obliguar – siç e keni lexuar edhe në material – që këto zona të cilat janë të parapara, t'i përfshijmë në Planin Zhvillimor Komunal dhe të fillojmë me procedurat për përgatitjen e këtij Plani. Besoj që e keni parë, në bazë të neneve, edhe afatin brenda të cilit duhet të realizohet dhe të përgatitet ky Plan. Deri në momentin kur të përgatitet, do të kthehet edhe një herë – pas dëgjimit publik – të miratohet pikërisht në këtë Kuvend. Prandaj, unë ju ftoj që ju ta votoni këtë Propozim-vendim që të fillojmë me procedurat për hartimin e këtij Plani, dhe shpresoj që pasi t'i kryejmë të gjitha obligimet që dalin nga ky vendim, ta kthejmë dhe ta miratojmë bashkarisht këtë Plan, i cili do të jetë një bazë shumë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Komunës sonë.

Uran Halimi: Meqenëse u ndërlidhem të PZhK-ja, vazhdimisht ka pas kërkesa për disa zona, disa qytetarë janë ankuar për shkak që Parku Nacional ka përfshi disa zona të tyre private dhe ata s'po mundin me investue nëpër pronat e tyre private. A është paraparë edhe ndryshimi i territorit ose i hapësirës ku përfshihet Parku Nacional nëpër ato zona. A keni me ndryshue atë pjesë, në atë mënyrë që me jau lejue atyre qytetarëve ose investitorëve që me investue nëpër pronat e tyre, të cilat i kanë tashmë private.

Bexhet Xheladini: Siç tha drejtori i Buxhetit, PZhK-së i ka skadue afati dhe, edhe pse ai ka skadue, vazhdon të jetë në fuqi deri sa nxirret i riu. Ne vitin e kaluar kemi planifikuar që të fillojmë procedurat, mirëpo ndërkohë kemi pas disa takime zyrtarët e Ministrisë dhe na kanë thënë që Qerveria është duke përgatit ligjin që edhe hartat zonale, edhe PZhK-në do me i përfshi me një ligj. Mirëpo, pasi që ligji ka ngec nga viti i kaluar deri më sot, ne para një muaji e kemi pas prapë një takim me zyrtarët e Qeverisë dhe e kemi marrë një vendim dhe një qëndrim prej tyre që ne të fillojmë së pari me PZhK-në, pastaj pasi të miratohet, do të fillojnë procedurat edhe për hartat zonale. Sa i përket pyetjes së Uranit për qytetarët të cilët kanë prona në Parkun Nacional, ne i kemi pas dy takime deri më tani me zyrtarët e PK-së, dhe e kemi arrit një marrëveshje me ta, që ne si Komunë t'i çojmë kërkesat tona drejtuar Ministrisë, dhe t'i tregojmë vendet dhe zonat ku ne planifikojmë që të bëjmë ndërtime, edhe qytetarët edhe ne si Komunë. Ne i kemi përgatit thujse shumicën e propozimeve dhe planifikojmë që, brenda 10 ditëve, t'ia dërgojmë MMPHI-së këto propozime. Njëra ndër propozimet është të kërkojmë nga zyrtarët të cilët merren me Parkun Nacional që qytetarët të cilët kanë prona në PK, atyre t'u lejohet ndërtimi, bazuar në kushtet që ofron PK. Këtë kërkesë ata gojarisht e kanë pranue, kanë thënë është kërkesë e pranueshme, ne do ta dërgojmë me shkrim. Masnesër e kemi një takim Bordi i Drejtorëve, do të marrim qëndrimin definitiv dhe të gjitha këto do t'ia përcjellim Ministrisë së Planifikimit Hapësinor.

Arijeta Skeraj: A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 24 vota pro, 1 kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Pasi që shumë asambleistë po kërkojnë pauzë, në ora 13:00 kthehem në sallë!

Atëherë po fillojmë. E kemi pikën e pestë: Vendimi për tejkalimin e mjeteve vetanake të buxhetuara në vitin 2023 dhe të barten në vitin 2024.

Arijeta Skeraj: Munir, ne e kemi te pika për tejkalimin e mjeteve vetanake prej vitit 2023 të barten në vitin 2024. Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 13 vota pro, 2 kundër dhe 2 abstenim, miratohet edhe kjo pikë. Kalojmë te pika e gjashtë: Vendimi për rialokimin e mjeteve të buxhetit për vitin 2024.

Munir Jonuzi: Faleminderit, zonja kryesuese, doja t'ju pyesja se meqë nuk e kam dëgjuar përkthimin, nuk më është ndezur mikrofoni, nëse është kështu. Që tani është në rendin e ditës të kuvendit që e votuam pak më parë. Ky vendim i qeverisë. Atëherë mund të vazhdoj. Të nderuar delegatë, e kam parë vendimin e Qeverisë ku thuhet se nga mjetet që nuk janë shpenzuar nga viti paraprak duhet të kalojmë në disa mjete që do të jenë këtë vit, mirëpo në vendimin e Qeverisë nuk është paraparë se si do të ndahen ato mjete. Nëse ato fonde të pashpenzuara do të devijoheshin në ato projekte që nuk përfunduan, atëherë nuk do të ishte problem për mua, do ta mbështesja menjëherë një propozim të tillë, dje në komisionin për politikë dhe financa votova për vendimin që parashikon përfundimin e projekte të papërfunduara. Megjithatë, lexova edhe shtypjen e imët në këtë dokument, që më mbajti zgjuar gjithë natën. Thjesht nuk mund ta besoja se diçka e tillë është e mundur, nëse shikojmë listën e projekteve të papërfunduara, të papërfunduara, do të shohim se ka projekte të papërfunduara në rajonin e Gorës. Nëse shikojmë se ku po ridrejtohen këto fonde, atëherë është rajoni i Opojes. 80 % e projekteve të papërfunduara janë në Gora, 70% e fondeve të destinuara janë në Opoje. Më vjen keq që duhet të flas kështu, sepse për mua personalisht dhe për delegatët e tjerë nuk është problem që për shkak të rëndësisë së situatës, për disa prioritete, të ketë një përqindje më të lartë në Opoje. Nëse kjo ndodh gjatë gjithë kohës, nëse përsëritet pa ndërprerje, atëherë nuk më mbetet gjë, por si njeri, si delegat, si deputet i kuvendit kryesues, reagoj për një padrejtësi të tillë. Të hyrat vetanake janë votuar në seancën e kaluar. Pra, raporti i shpërndarjes ishte 65 me 35. Që është shumë më i ulët se sa parashikon shpërndarja proporcionale e buxhetit. E cila bazohet në regjistrimin e vitit 2011. Javën e kaluar kemi votuar për këto projekte, të cilat tani ekzistojnë, prandaj mjetet e papërdorura kalojnë në ato projekte që janë votuar në seancën e kaluar. Le të themi, nëse shtojmë 5000 të tjera ose 10000 të tjera për një projekt, do të thotë se me ato fonde presim ta përfundojmë atë projekt, prandaj janë lënë mënjanë. Në fund do të më duhet të jem personal, që natyrisht nuk më pëlqen, kemi pasur 3000 euro për përfundimin e ujësjellësit, të cilat i kemi ndarë në

gusht të vitit të kaluar në fshatin Rapçë. 3000 do të thoshte se ne mund ta përfundonim më në fund këtë projekt, i cili tashmë po bëhet historik. Domethënë, ai projekt ka filluar në vitin 2020, ende nuk ka përfunduar, me të gjitha mjetet e veçanta që i kemi ndarë atëherë, është dashur të përfundojë deri në vitin 2022. Por për shkak të neglizhences të vazhdueshëm të drejtorisë së urbanizmit nga ndonjë intolerancë personale ose ndoshta nga ndonjë hakmarrje ndaj meje, ndoshta për të më treguar se jam i paaftë si delegat, por kjo nuk është në përshkrimin e ne delegatëve. Ne nuk mund të përfundojmë disa projekte, ne propozojmë vetëm projekte dhe pushteti ekzekutiv është ai që do t'i zbatojë ato projekte. E vetmja gjë që është e paaftë këtu është ajo direktori. Por fatkeqësisht kjo qeveri do ta paguajë paaftësinë e tyre në zgjedhje. Sepse vazhdimisht injoron nevojat e banorëve të fshatit Rapçë, si dhe të shumicës së Gorës. U bëj thirrje të gjithë delegatëve, delegatëve të LDK-së, delegatëve të PDK-së, të VV-së, e veçanërisht delegatëve të komunitetit joshumicë, që të mos e mbështesin një propozim të tillë, sepse nuk është në interes të banorëve të kësaj komune. Nuk është as në interes të dëshirave të komunitetit joshumicë.

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, unë deshta të them se konstatimet e z.Munir Jonuzi nuk qëndrojnë aspak. Është një diskutim për t'i nxitur delegatët e komunitetit joshumicë që të votojnë kundër. Këtë metodë e ka përdorur edhe kur është votue Ujësjiellësi. Sa herë e sheh që koalicioni pak me numra nuk është mirë, ky bën këso lloj lojëra. Unë veç deshta të them se shumica dërmuese e këtyre mjeteve shkojnë për investime të përbashkëta. 60 mijë euro shkojnë për kulturë; 60 mijë euro shkojnë për ndërtimin e stadionit, asfaltimin e rrugës Dragash-Stadion i qytetit. Gjithsej janë afër 200 mijë euro. Gjithashtu, nuk i ka përmend edhe mjetet 10 mijë euro, që janë mjete prapë të përbashkëta, që shkojnë për QKMF-në në Dragash. Gjithashtu, në bazë të këtij propozim-buxhetit, diku 14 mijë euro shkojnë për Gllloboqicë, për ujësjiellësin; edhe për QMF-në në Krushevë shkojnë 18 mijë euro. Ndarja proporcionale e buxhetit nuk matet siç po konstaton z.Muniri, por matja e ndarjes së drejtë financiare bëhet në fund të vitit dhe ne atë e kemi realizue më shumë se 41.3%. Nëse ky mendon se nuk është e vërtetë, atëherë mund ta formoni një komision nga Kuvendi edhe t'i sheh këto investimet kapitale, a janë më pak se 41.3%. Faleminderit!

Munir Jonuzi: Faleminderit kryetar, zoti kryetar, asnjëherë nuk kërkoj nga delegatët, veçanërisht jo nga delegatët e komunitetit joshumicë, të mbështesin diçka për t'i manipuluar. Unë thjesht po flas për faktet. Këtu thuhet se ne duhet të rialokojmë 91,640 euro, nga ato 91,640 euro, 72,525 ishin nga rajoni i Gorës, që do të thotë projekte të papërfunduara në rajonin e Gorës, dhe 19,113 ishin në rajonin e Opojes, si i ridrejtua ato fonde? Ne i ridrejtua si më poshtë: 45,341 euro për Opoje dhe 24,000 euro për Gora. Nuk është ndarje proporcionale e buxhetit dhe ne kemi 27 mijë që ju thërrisni për fonde të përbashkëta, pastaj keni bërë gabim ose na kanë dhënë një gabim të tillë në përkthim, ju thoni kemi ndarë 40 mijë për Gllloboqicë, jo kemi ndarë 14 mijë për Kukuljan. . Kështu , në vitin 2022

votuar për ndërtimin e ujësjellësit në fshatin Kukuljanë, ai projekt ishte për dy vite, do të kushtonte rreth 50 mijë euro. Ne kemi lënë mënjane 30,000 euro për 2023 dhe 18,430 për 2024. Pse është kjo 18430, sepse kemi llogaritur që me atë shumë para ose një kontratë e tillë ka qenë 48430 do të përfundohet projekti. Mirëpo ne nuk e kemi përfunduar, kështu që në kuvendin e kaluar kemi pasur propozim për ndarjen e mjeteve të pashpenzuara. Sërish kemi ndarë edhe 14 mijë euro nga të ardhurat tona për fshatin Kukuljanë. Shikoni të ardhurat e mëparshme dhe do të shihni, ne arrijmë në rreth 62,000 euro. Dhe kjo nuk është e gjitha, ne kemi një vendim tjetër që thotë se duhet të ndajmë edhe 14 mijë, nuk e di se çfarë ujësjellësi po ndërtohet në fshatin Kukuljanë nëse na kushton 76 mijë euro. Duhet të jetë me përmasa të mëdha dhe jo përmasa që do të kënaqin një fshat me rreth 1500 banorë.

Driton Ademi: Deshta me u ndërlidhë pak te Vendimi, në muajin e tretë që i kemi bart mjetet vetanake. Asfaltimi i rrugës Dragash-Stadion-Dragash, kryetari po thotë që i kemi ndarë 60 mijë euro. Sapo e tha edhe tash, edhe në muajin e kaluar i kemi ndarë 60 mijë euro. Te Vendimi i sotshëm, të rialokimi, këtu po thotë që i kemi 27 mijë euro. Domethënë, 87 mijë janë, a 27, a 60? Atëherë, unë s'po e shoh shumë të arsyeshme, kryetar, që je t'u thënë të njëjtin vendim, se para një muaji ndërtimi – mbuloja e Stadionit në fshatin Bresanë – 21 mijë euro. Me shumën jemi në rregull, projekti është 51553, në rialokim e ke projektin 51378 – Ndërtimi i pllakës dhe kulmi, si dhe renovimi i Shkollës Fillore “28 Nëntori” në Bresanë. Pse u ndërrue emërtimi, se kur ta kam bo pyetjen në seancën e kaluar, a mundim me i ridestinue diku tjetër këto pare... po mirë, unë deshta një arsye për këto pjesët ...jo, nuk është e ndarë në dy grupe, shumat e njëjta s'munden me u nda në dy grupe. Ose kushtojnë 42 mijë euro, ose ia ke ndërrue emrin e projektit, se nuk po të përputhet me projektin e muajit të kaluar. Mjetet vetanake, destinimin edhe kodi nuk po përputhet. Mjetet vetanake të cilat i kemi ndarë muajin e kaluar, nuk po përputhen me të sotit. Unë veç po ta lidhi në Bresanë, ndërtimi i mbulojës së Stadionit në fshatin Bresanë, projekti 51553, shuma është 21,744.50 euro. Po sot që e ke pru këtë, rialokim, tjetër send po thotë në Bresanë: Ndërtimi i pllakës dhe kulmi, si dhe renovimi i Shkollës Fillore “28 Nëntori”. Domethënë, s'ka të bëjë mbuloja me kulmin e shkollës. E para, e dyta: Renovimi i shkollës së vjetër “28 Nëntori” në fshatin Bresanë – 12 mijë euro, sot në rialokim nuk po i shoh këto 12 mijë euro kërkund që janë të ndame. Nëse keni ju naj listë tjetër, ajo tjetërçka është, unë në listën e re nuk po i shoh kërkund që është kjo. Kisha pas qef një sqarim pak më të detajuar, ose nëse i keni destinue me emra të ndryshme, atëherë unë kërkoi këto para me u destinue – nëse destinohen – tjetërkund, jo me këto projekte. Se unë besoj se këto projekte, të dyjat janë përmbyllë, sidomos kulmi i shkollës fillore. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Dëshiroj të falënderoj zonjën Presidente, kolegut Jonuza, më vjen shumë keq, përkundër përpjekjeve tuaja për t'i rikthyer gjërat në normalitet, që pas dy vitesh e tetë muajsh e kuptove se kjo qeveri është katastrofike për rajonin e Goranit. Unë ju fola për këtë që në fillim, kam folur në të gjitha këto seanca deri më tani, duke shpjeguar se si kjo qeveri është katastrofike për

rajonin e Goranit në tërësi dhe se është e angazhuar ekskluzivisht në ndarjen dhe shkatërrimin e rajonit të Goranit. Një tjetër gjë, që e mbështet këtë pretendim tim, është fakti se edhe sot në vetë seancën nuk shohim përfaqësues të pushteteve që duhet të mbrojnë interesat e komuniteteve, ata nuk janë të pranishëm në këtë kuvend. Nuk e shohim këtu të pranishëm shefin e zyrës për komunitete, as nuk shohim ndonjë nga zyra për komunitete, nuk shohim asnjë drejtor nga rajoni i Goranit në këtë sallë. Koleg Jonuzi a shihni ndonje regjisor nga rajoni i goranit, sa per koleget delegate qe jane ulur prane meje ne stol, mendoj se e keni te qarte qe ketu jane si ne nje teater kukullash, per te ngritur doren si i urdhëron kjo qeveri. E kam thënë që në fillim se kjo qeveri është katastrofike për popullin tonë në Gorë. Se nuk bëjnë asnjë projekt me cilësi dhe ato projekte që i zbatojnë në terren janë të lëmuara dhe të kota. E treta, kolegu Jonuzi, kjo ndarje e buxhetit i vjen në të njëjtën mënyrë kur një grua ka, përveç djalit, edhe dy fëmijë që i ka sjellë i shoqi nga martesja e parë, ndaj i blen çokollatë dhe i thotë unë jam një njerë e mirë, do t'i blej nga një çokollatë. Ata duhet t'i japin gjysmën djalit tim biologjik. Kështu ndahet kjo shpërndarje, shpërndahet 45% me 55%. Projektet në Gorë nuk kanë mbaruar dhe më pas bëhet zhvendosja ashtu siç e keni bërë ju. Unë ju mbështes plotësisht në këtë dhe më vjen shumë keq që pas dy vitesh e tetë muajsh ju duhet të kuptoni se kjo qeveri nuk ishte e duhura për rajonin e Goranit. E treta, zoti kryetar shtoi faktin se dikush po manipulon me ujësjellësin këtu. Askush nuk manipulon me furnizimin me ujë, njerëzit erdhën këtu në debat publik dhe shprehën pakënaqësinë e tyre. Ata thanë se nuk ka nevojë të vendoset ujësjellësi në ato fshatra dhe se nuk ka nevojë për ujësjellës, sepse problemet e ujit janë zgjidhur . Më pas Kukaljtane, mbi 70.000 euro për ujësjellës + për ta futur atë fshat në ujësjellësin qendror. Çfarë kuptimi ka. Është e paqartë, faktet janë të paqarta. Pse njerëzit tanë që janë përgjegjës për gjendjen e komunitetit si Uzair Hamza, shefi i zyrës së komunitetit, si z. Mirale Rahte, kryetarja e komitetit të komunitetit, pse nuk përgjigjen. Ata janë të detyruar të reagojnë menjëherë ndaj shkeljes së këtyre të drejtave. Kjo qeveri i ka uzurpuar dhe po bëjnë gjëra nga të cilat përfitojnë kjo qeveri, jo qytetarët e komunave tona.

Bexhet Xheladini: Atë që e diskutoi Nedžmidin Sejdilar, se pse nuk është në sallë shefi i Zyrës së Komuniteteve, ai sot është në një takim shumë të rëndësishëm, është në Komisionin Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, që është anëtar i Komisionit Komunal.

Uran Halimi: z.Hamza – Uzairin është fjala – e pashë t'u i transportue ata nxënës, q'atëherë kur dolëm në pauzë. Bon vaki u kthye prej takimit, i nderum kryetar. Nashta kam pa edhe ëndërr, njëri kemi pa, ja ti, ja unë. Te lojërat politike, që i thatë zotit Jonuzi, e kam e të drejtë. Ne mundim mos me i rialokue këto pare, meqenëse e kemi votue buxhetin me këto destinime, pse t'i rialokojmë tash? Tjetra, te fshati Kuk, unë kam folë edhe te asfaltimi në fillim kur ia keni nis, asfaltimin e rrugës atje në bjeshkë, e këtu poshtë kurgjo s'keni bo. Plus, qetash po doni me e lënë, mos me vazhdue atje. Qysh duhet me shkue qytetarët me e shijue atë asfaltin e ri që është gropos hala pa u pre shiriti aty. Po e shoh që po i

hiqen këtu 19 mijë euro, s' e di a i qiten mo ose jo. Tjetrën e kemi rialokimin e parave për destinimin e mjeteve ose automjeteve në QKMF. Kanë kalue në renovim të objektit. Z.Loshaj edhe ata që punojnë në QKMF, e dinë edhe vazhdimisht janë ankue që ato mjetet, ambulancat nuk funksionojnë. Njëri tha ecën më së shumti 40 km/h, një tjetër nuk ecën hiç. Objekte kemi, pacientë zero, degradimi i QKMF-së është mëse i dukshëm në Komunën tonë. Edhe tjetra, investimet në objekt sa të duash, shërbime zero, pacientë zero. Ju lutem kryetar, nëse është mundësia edhe ka pakënaqësi, pse me i rialokue, na këto pare i kemi. Lëri në destinimet të mëhershme që kanë qenë! Pse me i rialokue qetash, duhet dikujt me i marrë, dikujt me i dhënë, po shprehen pakënaqësi. I lëmë qashtu qysh janë. Cila është esenca, ku është qëllimi që me e lënë pa rregullim të ujësjellësit fshatin Rapçë, e me e rregullue rrugën e stadionit, kur stadiumi është pa rregullue. A po kupton? Një pjesë të rrugës, ose njërën rrugë Stadioni i Dragashit e ka. Ujësjellësi është elementi kryesor për jetën tonë. Po e largojmë ujësjellësin, po e shtimë rrugën. Sidoqoftë, ne si LVV nuk e mbështesim këtë rialokim të mjeteve.

Bexhet Xheladini: Nuk kemi hek ujësjellës kërkund në projekt. Tash po flesh edhe ditën! Sa i përket automjetit, unë ta kam sqarue edhe dje. Këto mjetet kanë qenë të parapara për vitin e kaluar. Viti i kaluar ka qenë viti 2023, tash është viti 2024. Këto mjete në vitin 2023 nuk kanë mund, për një arsye apo një tjetër, me u shpenzue për destinimet që i kemi votue. Tani ligji Qeverisë Komunale i mundëson që këto mjete, ose me i lënë aty ku kanë qenë vitin e kaluar, ose me i ridestinue ku të do Qeveria Komunale, ku e sheh më shumë të arsyeshme. Ne e kemi parë të arsyeshme që këto mjete të ridestinohen ashtu siç e keni marrë vendimin. Vitin e kaluar kanë qenë mjetet e ndara për blerjen e automjeteve dhe ne kemi bërë përpjekje që t'i blejmë ato automjete. Ndërkohë, Qeveria qendrore ka pru Vendim që komunat nuk kanë të drejtë me ble automjete, sepse ata kanë lidhë marrëveshje me një kompani qendrore, ku aty na kanë caktue edhe cilat kerre kemi të drejtë me i marrë. Por megjithatë, ne jemi pajtue edhe ato kerre që kanë thënë me i marrë, edhe ato me i marrë. Kur kemi lyp me na i pru kerrat, kanë thënë jo se një prej kompanive është ankue edhe lënda është në OShP. Edhe lënda deri në vit të ri ka qenë në OShP, edhe sot e kësaj dite është në OShP. Ne nuk mund më të rrezikojmë edhe një herë, t'i lëmë ato mjete për automjete, edhe pastaj prapë mos me mund me i ble automjetet, sepse nuk kemi të drejtë ne ta shpallim më tender me ble automjete. Kështu që, për këtë qëllim, ne ato mjete prapë i kemi ndarë në shëndetësi, një pjesë e kem ndarë në QKMF, një pjesë në QMF-Krushevë. Te asfalti në Kuk: Këto mjete kanë teprue, projekti është krye. Ato gropat ti që po i përmend, ato janë asfalt i shtuar tepricë, edhe atë asfalt na nuk e kemi pague edhe nuk e kemi pranue si punë. Kështu që, ai është asfalt i qitur nga kompania pa pagesë, edhe na nuk e kemi bo as pagesën, as pranimin e atij asfalti.

Uran Halimi: Tash kryetari tha që nuk po hiqen paret e ujësjellësit. Unë ju kisha lut juve me e lexue aty te kolona e parë, te kodi 50606, ku po shkrun "Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Rapçë". Kanë qenë të parapame 3 mijë euro për rregullimin e ujësjellësit të fshatit Rapçë. A po i bjer qekjo që

ka të bëjë me ujin, a jam gabim unë? Në pjesën tjetër ku po rialokohen mjetet, nuk është rregullimi i ujësjellësit në fshatin Rapçë. Tash unë s'po e kuptoj qysh po thotë kryetari, s'ka të bëjë po thotë s'ka rregullim të ujësjellësit. Kryetar, në kolonën e parë e kie. Tash te bjeshka e Kukit tha donacion, u gjujt një asfalt i tepërt. Ishalla kemi tepër na asfalt, sa me gjujt nëpër bjeshkë, e i ke rrugët në Zgatar, e ke fshatin Brrut komplet me infrastrukturë të shkatërrume brenda në fshat. E ke edhe atë rrugën – mirë ka qenë asaj gropës te Brruti me ia gjujt do asfalt që ka teprue, se goxha u bo njëfarë grope e mërzitshme aty.

Driton Ademi: Kryetar, edhe pse nuk m'u përgjigje me asnjërin pyetje, po due me dalë edhe një herë me ta thënë, sapo tha tash vetë, ku e kemi parë të arsyeshme me i nda na, me i destinue këto pare. Ti e thaje këtë. Kur të kam pyet herën e mbramë, ti më ke thënë s'mundim me dalë jashtë projektit. Ti sapo e tha, ku e kemi parë të arsyeshme i kemi ndarë. Atëherë, nëse mundesh me i nda, të qe ky projekti e kemi më të arsyeshme për me i nda për mbledhësin e ujërave atmosferikë, për të cilën kam folë edhe në seancën e kaluar. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdlar: Ju falënderoj zonja Presidente, presidenti pak më parë iu përgjigj z. Haljimi se ka përfunduar projekti i ndërtimit të ujësjellësit në fshatin Rapça. Kolegu Jonuzi, nëse e kuptova mirë, protestoi këtu se nuk kishte mbaruar. Tani dua të pyes kryetarin e komunës sonë, sepse vërtet nuk mund ta kuptoj nëse ka përfunduar apo jo. Nëse ai dëshiron të na tregojë se kush po gënjejnë këtu, a gënjen zoti Jonuzi apo po thotë gënjeshtër zoti kryetar. Jonuzi këtu ka protestuar se fondet janë destinuar diku tjetër dhe është në pritje të përfundimit të ujësjellësit dhe kryetari i komunës i është përgjigjur zotit Haljimi se ujësjellësi në Rapçë ka përfunduar. Për hir të këtyre qytetarëve që presin të pinë ujë, do të më interesonte, nëse do të tregoheshë aq i sjellshëm sa të shpjegoni, kryetar bashkie, nëse ka mbaruar apo jo ujësjellësi dhe pse sot nuk mund të pinë ujë.

Shpetim Hajredini: Tash nuk do të hyj dhe të diskutoj në atë formën apo formatin si diskutuan deri më tani këta kolegët e mi. Unë do të mundohem të jem i qartë për qytetarët, se ne të gjithë e kemi kuptue esencën, thelbin e kësaj çka u diskutue deri më tash, por qytetarët nuk e kuptojnë se pse dhe çka kemi diskutue deri më tash. Andaj unë do të mundohem ta jap një shpjegim pak më të detajuar për ata të cilët edhe nëse qëndrojnë këtu në Asamble dhe nuk e kanë kuptuar çka ka ndodhë. Por, gjithçka që do e lexoj pastaj, ka të bëjë më shumë për qytetarët, për ta kuptuar ata. Propozim-vendim për rialokimin e mjeteve të buxhetit për vitin 2024, Neni 1 thotë: Me këtë Vendim mjetet rialokohen, Fondi Burimor 22, shuma 115,788.22 euro. Neni 2 thotë: Fondi burimor 22, Investimet Kapitale, planifikimi urban dhe inspeksioni 660/66350 – kjo është shumë me rëndësi që ta mbajmë në mend, për me e ditë në fund pastaj se çka ka ndodhë. Mjetet financiare nga projektet 50606 – rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Rapçë, 3 mijë euro Të nderuar qytetarë, këta numra që po i them janë kode të projekteve prej të cilave është marrë shuma e cila ka qenë në deficit në vitin 2023 dhe në vitin

2024 është bart në projektet tjera. 51401 – asfaltimi i rrugës Zlipotok-Glloboqicë, 17 mijë euro; 51222 – asfaltimi i rrugës për bjeshkë në fshatin Kuk, 19,113; 51554 – ndërtimi i terreneve sportive në Glloboqicë, një shumë 0.50 euro; 52421 – rregullimi i pronës dhe ndërtimi i parkingut, kubëzimi në fshatin Rapçë, 18,785; 52697 – kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i kanalizimit në fshatin Zlipotok, 3,367; 52713 – kubëzimi dhe kanalizimi në fshatin Restelicë, 30 mijë euro. Këto shuma të cilat i lexova, në total janë 91,640 euro, të cilat kanë qenë suficit në vitin e kaluar. Dhe, në këtë vit, janë bartur nga ana e ekzekutivit në projekte të tjera. Si rrjedhojë, do të vazhdojmë t’i lexojmë patjetër në projektet të cilat kanë kaluar. I nderuar kryetar, e thashë shumë qartë, jo për delegatë se këta e dinë, po për qytetarët të cilët nuk po e kuptojnë se çka po ndodh. Po thotë: Mjetet financiare nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Inspektionit, që thashë më herët 66066350 pra, bartend he rialokohen në projekte të tjera, siç janë në vazhdim: 51378 – ndërtimi i pllakës, kulmit dhe renovimi i shkollës fillore “28 Nëntori” në Bresanë, 21,744; 54718 – asfaltimi i rrugës së Kuklibegut bjeshkë, 2,340 euro; 51378 – asfaltimi i rrugës Dragash – Stadium, 27 mijë euro; Ndërtimi i urës në Qollopek, 8 mijë euro; Kubëzimi i rrugëve në fshatin Pllavë, 5 mijë euro; Ndërtimi i Impiantit për ujëra të zeza në fshatin Brezne, 8,252 euro; Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i murit mbrojtës te rruga ‘Abdyrrahman Gërdellaj’ në fshatin Rrenc, 5 mijë euro; dhe Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Kukajan, 14 mijë euro. Të nderuar qytetarë të Dragashit, gjithçka që kanë diskutue deri më tani kolegët dhe unë personalisht, ka të bëjë me bartjen e kësaj shume prej 91,640 që ka teprue në projektet të cilat besoj se shumica prej tyre janë të finalizuara dhe janë të paguara aq sa janë finalizue. Ndërsa, këto shuma kanë kalue në suficit, dhe kanë mundësi ekzekutivi që t’i bartin dhe t’i përdorin aty ku unë edhe i lexova më herët, në projekte të cilat këta mendojnë se janë më të arsyeshme. Por, për mua nuk është e arsyeshme që qe ky 19,113 euro – asfaltimi i rrugës në fshatin Kuk që ka qenë për bjeshkë. Ky suficit është dashtë të përdoret për fshatin Kuk dhe jo të bartet në projektet tjera. Unë po flas për lokalitetin dhe fshatin tim, se thojnë ku dhëmb dhomi shkon gjuha. Edhe mu po më dhëmb dhomi aty, edhe po diskutoj për të, se për tjerat projekte biseduan edhe shumica prej kolegëve të mi, për lokalitetin e tyre. Prandaj, ne deshëm apo s’deshëm, unë personalisht nuk e votova, por edhe si grup parlamentar i PDK-së nuk e mbështetëm edhe më herët. Prapë nuk do ta mbështesim, pasi që mendojmë nuk është i arsyeshëm kjo ndarje dhe ky devijim. Fshati Kuk ka pas nevojë për këto pare, asfaltimi i rrugës së bjeshkës ka pas nevojë, edhe pse kjo shumë e di që nuk i mbulon investimin i cili duhet të kryhet për pllakën apo shtresën e dytë të asfaltimit të kësaj rruge. Por, sado pak do ta kishte mbulue një pjesë apo disa çalime të cilat po shihen tani, qysh herët në pranverë, që kanë ndodhur në mosrealizimin e duhur të atij projekti. Unë besoj që për të gjithë ata qytetarë të cilët më shënuan deri më tani se çka është duke ndodhur, kanë informacionet e nevojshme se për çka diskutuam deri më tash. Dhe për fund, unë nuk e mbështes këtë Propozim-vendim. Ju kryetar, besoj që i keni votat, ndoshta edhe do ta kaloni. Ju

falemnderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, Shpetim! Besoj se u diskutua shumë rreth kësaj pikës. Atëherë, e hedh në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 13 vota pro, 11 kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Atëherë, kalojmë te pika e shtatë: Informatë rreth Regjistrimit të Popullsisë.

Nedžmidin Sejdlar: Faleminderit zonja kryetare, prisja që të paktën dikush nga komisioni përgjegjës për regjistrimin të merrte fjalën dhe të na informonte për situatën në terren, megjithatë askush nga komisioni nuk është aktualisht i pranishëm në këtë sallë përveç kryetar i komunës. Kush nuk ka dashur të marrë fjalën dhe të na japë asnjë informacion në lidhje me regjistrimin. Dje ishim në komitetin për komunitete bashkë me kryetarin e komisionit dhe shefin e zyrës për komunitete që aktualisht është në Prishtinë dhe i vozit fëmijët këtu nëpër Dragash, njeriu e klonoi veten, nuk e di si ia doli. por gjithçka është e mundur sot. Ne patëm një diskutim të gjallë për çështjen e regjistrimit dhe arritëm në faktin se regjistrimi është shumë i rëndësishëm për vetë komunën tonë. Sepse të gjithë ne këtu, të dashur kolegë këshilltarë, jemi të vetëdijshëm se nëse numri i banorëve në komunën e Dragashit bie nën 30.000, kemi mundësi që ky numër të bjerë, duke qenë se regjistrimi është i dobët dhe i cilësisë së dobët, buxheti. e komunës sonë do të zvogëlohet në radhë të parë për disa milionë. Pra, ne do të mbledhim xhep shtesë për investimet kapitale të qytetarëve tanë. Ne e dimë që nëse në komunën tonë zvogëlohet numri i banorëve, e para që do të ndodhë është që buxheti i kësaj komune të zvogëlohet për disa milionë dhe kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në investime kapitale, në fakt do të ndikojë drejtpërdrejt tek qytetarët e komunës sonë. . Tjetër, nëse popullsia e komunës së Dragashit zvogëlohet, do të zvogëlohet edhe punësimi , që do të thotë se përveç papunësisë do të duhet të shkurtojmë edhe disa vende pune. Në vetë komunën tonë do të kemi numër shumë më të vogël të të punësuarve. Nëse numri bie nën 30.000, edhe vendet në këtë kuvend do të ulen nga 27 në 21 delegatë, mendoj se është edhe në interesin tuaj personal të mendoni për këtë. Sepse disa prej nesh nuk do të ulen në këto banka pas zgjedhjeve të ardhshme. Përveç kësaj, një gjë shumë e rëndësishme është e rëndësishme në lidhje me regjistrimin, ajo që kam arritur të zbuloj nga terreni është se regjistruerit përdorin tableta, por në rajonin tonë, kryesisht në rajonin e Gorës, rrallëherë kanë tre ose katër rrjete G. dhe teknikisht nuk janë në gjendje të bëjnë një regjistrim cilësor. Unë i respektoj të gjithë ata djem. Se si e bejne ate pune mund vetem te lavderoj sepse une personalisht pata mundesine te sigurohem kur me erdhi regjistruesi ne shtepine time ku jetoj, kaluam diku rreth 2.5 ore per dicka qe mund te kishte zgjatur rreth 20 minuta per shkak pamundësi teknike. Prandaj i kërkoj anëtarëve të komisionit, i kërkoj asamblesë të krijojë një grup ose një grup pune për të shfrytëzuar të gjitha burimet tona të mundshme për të përmirësuar punën e atyre regjistruesve, në mënyrë që ata të kryejnë mirë regjistrimin, pastaj të inkurajoni popullatën që t'i përgjigjet regjistrimit, sepse është e rëndësishme për

ta dhe për vetë komunën tonë, dhe thjesht duhet të krijojmë një grup, një komision, një fushatë për të shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme komunale në mënyrë që të shihemi sa më shumë nga popullit dhe t'u shpjegojë njerëzve pse është e nevojshme ajo listë dhe pse njerëzit duhet t'i përgjigjen regjistrimit sa më shumë që të jetë e mundur. Nëse përfundimisht numri bie nën 30,000 banorë, ne në fakt nuk i kemi bërë asgjë të mirë njerëzve tanë që jetojnë në komunën tonë.

Bexhet Xheladini: Unë tash fola me Uzair Hamzën, ai ka qenë bashkë me nënkryetarin e Komunës në takimin që është zhvilluar për Regjistrimin e Popullsisë në nivel qendror. Nënkryetari i Komunës është njëherit edhe nënkryetar i Komisionit Komunal për Regjistrimin e Popullsisë. Ndërsa Uzair Hamza është anëtar i Komisionit. Momentalisht e kanë krye mbledhjen edhe janë duke u kthyer për në shtëpi. Kështu që, ai që e paska pa duke i transportuar nxënësat, paska pa ëndërr ditën. Ose e ka pa dje edhe ka harrue, ka mendue se e ka pa sot. Dëgjo, tash do ta shihni Uzair Hamzën edhe në televizion, përcillne, sigurisht ka diskutue atje dhe i ka ngrit disa çështje shumë të rëndësishme. Sa i përket Regjistrimit të Popullsisë, organizator i këtij procesi është ASK-ja. ASK-ja i ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e mbarë të këtij procesi, në bashkëpunim me komunat i ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura, dhe siç e dini më datën 5 ka filluar regjistrimi i popullsisë. Është duke vazhduar dhe do të vazhdojë deri më 17 maj. Në Komunën tonë, sidomos në pjesën ku jeton komuniteti joshumicë, kemi pas disa vështirësi, kemi pas shumë vështirë me gjet regjistruer, persona të cilët do ta pranojnë një detyrë të tillë. Personat të cilët janë pranue, pas një ditë-dy një pjesë e tyre e kanë lënë punën, janë pranue tjerit, janë trajnue, kanë punue një ditë, e kanë lënë punën. Tash prapë edhe tre regjistruer në pjesën ku jeton komuniteti joshumicë e kanë lënë punën. Por megjithatë, Qeveria në bashkëpunim me Komunën do të marrin një qëndrim të përbashkët dhe do ta zgjidhin këtë problem. Asnjë qytetar i Komunës së Dragashit, i cili do me u regjistruer dhe që e ka obligim ligjor me u regjistruer, nuk do të mbetet pa u regjistruer, nëse ai pranon me u regjistruer. Ata të cilët nuk pranojnë, ne duhet me shkue në terren edhe me i bind, me u tregue atyre që regjistrimi i popullsisë është në të mirën e tyre dhe në të mirën e përgjithshme të Komunës sonë. Sepse ato që i tha parafolësi qëndrojnë, nëse bjer numri i banorëve kemi me pas shumë pasoja, duke fillue prej buxhetit, prej numrit të punëtorëve, numrit të asambleistëve, pastaj edhe koeficienti i pagave – nëse biem nën 30 mijë banorë – do të jetë pak më i ulët sesa në komunat tjera. Kështu që, ne duhet të punojmë aty ku jemi, secili ta japë kontributin e vet, dhe të bëhet regjistrimi i të gjithë personave të Komunës së Dragashit, në mënyrë që, së paku, të jetë ky numër çka është – 34 mijë banorë. Ju e dini që ne jemi duke u ballafaquar edhe me rënie të natalitetit, edhe me ikje të trefishtë të popullsisë, shpërngulje në Prizren, Prishtinë, Fushë Kosovë, edhe shpërngulje jashtë vendit. Por duhet ta dini një gjë, që Komuna i ka bërë të gjitha përpjekjet ligjore dhe i ka marrë të gjitha vendimet ligjore, që procesi i Regjistrimit të Popullsisë të mos mbetet në fajin e Komunës, por as në fajin e Qeverisë qendrore. Pra, krejt çka duhet të bëjmë ne është të punojmë që numri i banorëve në Komunën tonë së

paku të jetë i njëjtë siç ka qenë në vitin 2011. Është edhe një problem te regjistrimi i komunitetit joshumicë, të nacionalitetit boshnjak, ku në formularin e përkthyer në gjuhën boshnjake është bërë një gabim dhe është bërë alarmimi i këtij problemi në nivel qendror dhe besoj që së shpejti edhe këtë gabim teknik që u bë në formular do ta përmirësojmë, do ta bëjnë përkthimin adekuat, ashtu siç duhet me qenë. Faleminderit!

Munir Jonuzi: Duke qenë se kryetari i komunës është edhe kryetar i komisionit komunal të regjistrimit, më intereson sa anëtarë nga komuniteti joshumicë ka në këtë komision, duke qenë se jemi komunë deri në 80 mijë banorë. dhe me ligj kemi 9 anëtarë të komisionit komunal të regjistrimit. Prandaj më intereson se sa përfaqësues të joshumicë e kanë dhënë atë përqindje të përfaqësuar proporcionalisht sepse sipas ligjit komisionin komunal të regjistrimit e cakton kryetari i komunës në bazë të përfaqësimit të komuniteteve që jetojnë në atë komunë. Një nga detyrat e agjencisë komunale të regjistrimit është të ndërhyjë në çdo situatë që shfaqet si pengesë gjatë procesit. Me të drejtë presidenti pak kohë më parë tha se Agjencia e Statistikave të Kosovës bëri një gabim ku termin boshnjak e zëvendësoi me termin boshnjak. Agjencia e Statistikave të Kosovës e ka zgjidhur këtë problem dy javë më parë, duke i kërkuar falje njërit prej komuniteteve më të shumta në Kosovë. Ishte vërtet e çuditshme për mua se si një gabim i tillë mund t'i ndodhte njërit prej komuniteteve më të shumta në Kosovë. Personalisht, mendoj se është një lëshim i qëllimshëm. Regjistruesit nga komisioni komunal i regjistrimit përdornin tableta deri para dhjetë ditësh , përdornin softuer regjistrimi me termin boshnjak, i cili natyrisht nuk korrespondon me deklaratën kombëtare të boshnjakëve. Në disa tabela, ai gabim është korrigjuar, veçanërisht në tabelat që u përkasin regjistruesve boshnjakë, e dini se në bazë të regjistrimit të vitit 2011, ne kemi 14 goranë dhe 8 boshnjakë në komisionin komunal të regjistrimit. Të gjitha këto probleme zgjidhen në tabletët boshnjakë. Mirëpo, me të tjerët nuk u bë. Unë kam pritur nga ky komision dhe kam kërkuar që të thërrasin të gjithë regjistruesit në këtë sallë dhe në atë mënyrë të thërrasin përfaqësuesin e Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe në atë mënyrë të kontrollojnë tabletët dhe të bëjnë sinkronizimin në të gjitha pajisjet. Gjithashtu shpresoj që ky problem të zgjidhet sa më shpejt, sepse në këtë mënyrë shkakton tallje ndaj komunitetit boshnjak.

Jetmir Ajdini: Përshendetje për të gjithë! Kryetar, pasi që je kryetar i Komisionit për Regjistrimin e Popullsisë, a do të ishte mirë si kryetar i Komisionit, së bashku me anëtarët, të organizoni takime me kryesitë e fshatrave, të cilat veç i kemi të zgjedhura, t'i informojmë ata për regjistrimin e popullsisë, e përmes atyre të informohen edhe bashkëqytetarët tanë nëpër fshatra për rëndësinë që e ka regjistrimi i popullsisë, edhe qytetarët të jenë më të informuar, që është obligim ligjor regjistrimi i popullsisë. Si propozim, besoj se kishte me e bo një zgjidhje goxha të mirë.

Nexhat Selaj: Po më vjen mirë se kanë fillue edhe asambleistët minoritarë me i pa këto lojërat politike se si zhvillohen. Të paktën po më vjen mirë, më mirë vonë sesa hiç, dhe z.Muniri të bindet me këto lojërat politike të partisë në pushtet. Tek Regjistrimi i Popullsisë, në seancën e parë dhe të dytën unë kam kërkuar nga kryetari që t'i ketë ekspertë, njohës të mirë të demografisë, të popullsisë, e jo të sillen persona të cilët nuk kanë qasje fare. Z.Ajdini e parashtrori një pyetje shumë të mirë, por kjo u dashtë shumë më herët, koleg asambleist, pasi që ne jemi tash gati në përfundim të statistikave. E kjo pyetje u dashtë shumë më herët me u bo, që të zgjidhen komisionerë, që të ketë eksperta të kësaj fushe dhe të komunikojmë nëpër fshatra. Kështu që, kjo është krejt e vonshme. Pavarësisht, ndoshta që mund të ketë një rezultat, kjo është para përfundimit. E, Uzair Hamza është bërë i gjithanshëm, i shumëpërfundues nga kryetari. Aty ku shkon me vete e ka, mas dorës, e çon ku do, duke i pasur partitë në pushtet, të opozitës, të cilët ka eksperta të fushave të ndryshme, të komunikojë. Në fillim është zotuar se do të është kryetar i të gjithëve. Këtu unë nuk po shoh ndonjë transparencë. Kështu që, ne dhe krejt qytetarët duhet ta dimë se këto janë zgjedhje vendimtare të cilat vendosin për popullatën tonë. Dhe do të prekemi – jam shumë i sigurt – në të gjitha fushat. Ju faleminderit!

Nedžmidin Sejđilar: Ne e kemi debatuar shumë këtë pikë, çfarë më intereson mua, siç tha kolegu Selaj dhe zoti Ajdini, dhe të gjithë të tjerët që folën para meje, çfarë propozoni ju zoti kryetar si kryetar i komunës. kreu i pushtetit ekzekutiv le të punojmë së bashku për të stimuluar njerëzit që t'i përgjigjen regjistrimit. Kemi folur shumë këtu për negativët, çfarë kemi gabuar, si nuk funksionon e kështu me radhë, por tani nga ky podium po ju kërkoj si kreu i pushtetit ekzekutiv, si kryetar i kësaj bashkie, si nikoqiri i kësaj shtëpie, një propozim konkret, çfarë mund të bëjmë të gjithë së bashku për të bërë që regjistrimi të kalojë me efikasitet dhe sukses. Pra, a keni ndonjë plan konkret, ndonjë lloj strategjie apo duhet të presim që të vijë Uzair Hamza.

Bexhet Xheladini: Procesin e Regjistrimit të Popullsisë mos ta përdorni për politika të ulëta! Por, të punojmë të gjithë, në mënyrë që regjistrimi i popullsisë të ketë sukses. Secili ne mund të bëjmë punë tonë, të kërkojmë nga popullata që të regjistrohet, të kërkojmë nga anëtarët e KKR-së që të jenë në nivel të detyrës, dhe të gjejnë anëtarë të Komisionit të cilët e pranojnë detyrën edhe e kryejnë regjistrimin e popullsisë. Regjistrimi i popullsisë nuk është kompetencë e Komunës, është kompetencë e nivelit qendror. Komuna vetëm i ndihmon procesit. Komuna vetëm ka bërë përzgjedhjen e regjistruarëve, në bazë të konkursit që është shpallë, në bashkëpunim me ASK-në. Në përbërjen e regjistruarëve, çelësin e ka caktuar ASK-ja, sa kanë me qenë shqiptarë, sa kanë me qenë goranë dhe sa kanë me qenë boshnjakë, sa kanë me qenë regjistruarë, sa kanë me qenë mbikëqyrës, boshnjakë, goranë dhe shqiptarë. Mbikëqyrësit i ka zgjedhë Qeveria, do të thotë ASK-ja, kurse ne i kemi zgjedhë regjistruarësit, në bashkëpunim me ASK-në. Përbërja e Komisionit Komunal është 5 me 3, edhe një anëtar është nga niveli qendror. 5 janë shqiptarë, 3 janë të komunitetit joshumicë dhe një anëtar është nga

ASK-ja. Unë punë time e kam bërë, asnjë detyrë nuk e kam lënë mangu, pa e krye. Edhe përmes mjeteve të informimit, edhe përmes mjeteve sociale kam kërkuar që popullata t'i përgjigjen regjistrimit, arsye të duhet t'i përgjigjen – përfitimet individuale dhe përfitimet e përgjithshme si Komunës. Por, ne secili duhet të punojmë edhe mund të punojmë që ky process të ketë sukses. Mirë është që mos me nxit edhe mos me punue kundër, secili me e krye detyrën e vet dhe sigurisht që ky process do të ketë sukses. Ne gjatë kësaj jave do ta mbajmë një takim, vetëm po pres nënkryetari i Komisionit edhe Uzair Hamza të kthehen nga takimi, të shohim se çfarë sugjerime kanë marrë, edhe ne do ta thirrjmë një takim me regjistruarit në këtë sallë, dhe do të diskutojmë për hapat e mëtejshëm që duhet të marrim. Edhe kjo që po folim këtu, janë duke e përcjellë mjetet e informimit drejtpërdrejt. Dhe nga këtu unë apeloj që të gjithë qytetarët e Komunës së Dragashit t'i përgjigjen sa më masovikisht dhe të mos mbetet asnjë qytetar i Komunës sonë pa u regjistruar. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit, kryetar! Besoj që më diskutimet janë mbyllë edhe i keni marrë edhe përgjigjet. Atëherë, fillojmë te pika e tetë: Siguria në trafik. E ka kërkuar z.Driton Ademi.

Driton Ademi: Atëherë, te kjo pikë e rendit të ditës, siç e dimë, në tërë territorin e Kosovës po ndodhin aksidente, por edhe në Komunën tonë. Hiç ma larg se brenda dy muajve, në rrugën Bresanë-Blaç kanë ndodhë dy aksidente. Fatmirësisht, me lëndime të lehta kanë ndodhë. Ngjarjen para dy-tri ditëve që ka ndodhë, ka qenë i njoftum edhe kryetari, për shkak se pacienti ka shkue te kryetari për shërim, për udhëzime të mëtejshme. Atëherë, ne si Asamble Komunale, brenda territorit të Komunës, nga kryetari – bashkë me kryetarin edhe asambleistët – unë po mendoj që është një rrugë shumë më e mirë, te rrugët magjistrale, për me e gjet një zgjidhje të mundshme, me qit naj pengesë, ose çfarëdo lloj që është, kryetari me e pas njëfarë qasje në Ministrinë e Transportit, te rrugët magjistrale me e qit naj pengesë, ose çkado që të jetë, sidomos te rrugët që janë më të frekuentume. Është Zymi, Bellobradi, Buzezi, Bresana, Blaçi edhe Zaplluxhja. Në pjesën e Opojës po foli, normal edhe në pjesën e Gorës, po qekjo rrugë prej Tyrbes që është rrugë magjistrale deri në Zaplluxhe, që ka shpejtësi shumë më të madhe, sidomos autobusët, por edhe kerrat, një pjesë edhe e kamionëve, por këto dyjat janë më të rrezikshme. Rruga që ne i themi prej urës së madhe, sidomos, deri në Blaç, është rruga më e rrezikshme që janë duke ndodhë aksidente të njëpasnjëshme. Unë kërkoj nga kryetari që ta bëjmë një zgjidhje. Me të thënë të drejtën kam pas shumë presion edhe prej bashkëvendësve të mi, që me e gjet një zgjidhje të asaj rruge. Kemi bisedue edhe me kryetarin e fshatit, që duhet me e pas një zgjidhje, jo veç në Bresanë por në të gjitha rrugët magjistrale. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Kolegu Driton kishte absolutisht të drejtë kur e ngriti këtë çështje dhe mendoj se kjo çështje është po aq e rëndësishme për të gjithë qytetarët e komunës sonë. Qysh në fillim të këtij mandati ju kam kërkuar që ta rregulloni të freskët pjesën e rrugës ndërmjet Plavit dhe Vivës. Aty ku i keni instaluar dritat, tani do të doja t'ju pyesja nëse mund t'i ndizni ato drita. Keni instaluar dritat, keni

bërë dritat e rrugëve, por nuk funksionojnë, nëse mund të ndizni dritat. Tjetër gjë, ashtu siç ka probleme me sigurinë në komunikacion në Opole, me të njëjtin fenomen ka probleme edhe në Gorë. Ju tërheq vëmendjen, zoti kryetar, ju kujtohet që ishim bashkë në Globoçicë në një debat publik, kur ju pyetën nëse është e mundur të vendosen dy ose tre nga ata policë të shtrirë, sepse njerëzit me të drejtë kanë probleme edhe me vozitjen. shpejt nëpër fshat. Edhe ne në Dragash, gjatë stinës së verës, kemi probleme enorme anormale të vozitësve arrogantë, të cilët ndonjëherë vijnë nga jashtë, përderisa nuk na vrasin, këtë e kuptojmë të gjithë ne që jetojmë në Dragash. Ajo rrugë z.kryetar kah Kukuljan kishte tabela rrugore 40 km ne ore, megjithatë dikush me siguri e ka falenderuar tabelen dhe e ka hequr nese mundeni ne komisionin e sigurise per te terhequr vemendjen e policise qe te jete me shume. të pranishëm në ato pjesë të rrugës dhe ju si autoritet komunal të riinstaloni shenjat e komunikacionit që kufizojnë shpejtësinë e lëvizjes. Në kohët moderne shfaqen pajisje moderne, janë shfaqur një numër i tepërt i këtyre skuterëve elektrikë që lëvizin shumë shpejt dhe lëvizin në rrugën ku është menduar për lëvizjen e mjeteve motorike, gjegjësisht makinave. Ne e dimë që komuna jonë e Dragashit nuk ka rrugë adekuate ku do të përdoren këta skuterë, në këtë drejtim ju duhet komisioni që ju kryesoni ose kuvendi për të marrë një vendim ku do të kufizojmë të gjithë ata njerëz që janë adhures të atyre skuterëve elektrikë. , të përdorin këto pajisje në vende ku nuk do të ndërhyjnë në trafikun publik. Unë shpesh ngas në segmentin Dragaš Prizren dhe Prizren Dragaš, dhe shumë shpesh kam mundësi të takoj shoferët e atyre skuterëve që nuk kanë as sinjale drite gjatë natës. Një incident i tillë mund të çojë në një situatë me pasoja katastrofike, prandaj të gjithë duhet të organizohemi këtu dhe të bëjmë një lloj rregulloreje ose të gjejmë një zgjidhje për të zgjidhur të gjitha këto probleme. Ju lus, kryetar bashkie, t'i ndizni dritat që keni vendosur vitin e kaluar në Plavë, t'i ndizni natën.

Jetmir Ajdini: Te çështja e sifurisë në komunikacion, një pikë të cilën kisha pas qef me e ngrit është rruga prej udhëkryqit deri te shkolla e fshatit Zgatar. Ka nevojë për vendosjen e dy policëve të shtrirë dhe vendosjen e tabelave informuese për kufizim të shpejtësisë dhe për vendndodhjen e shkollës. Është rrugë që frekuentohet shumë prej nxënësve aty çdo ditë, edhe është rrugë që goxha shumë automjete lëvizin dhe nxënësit janë goxha të rrezikuar, derisa nuk ka as policë të shtrirë e as tabela informuese. Deri te pompa s'e di a ka nevojë – se s'e di a frekuentohet shumë prej nxënësve ajo pjesë – po që ka nevojë urgjente me intervenue është ajo pjesë, domethënë prej udhëkryqit deri te rruga e shkollës. Nuk besoj që kushton shumë nja dy policë të shtrirë edhe tabelat informuese me i vendos. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: A do dikush tjetër? Në qoftë se jo, atëherë edhe unë deshta me u kyç këtu, te siguria në trafik. Edhe unë kisha kërkuar prej kryetarit që të ketë më shumë lëvizje të Policisë së Kosovës, për arsye se rastet që kanë ndodhë në dymujorin e fundit – ata janë trajtue edhe në Spitalin Regjional të Prizrenit. Unë deshta edhe të ndriçimi te Pllava, që e ceku Sejdlari, edhe aty le ta marrë me seriozitet. Dhe e treta që kisha kërkuar, tash është koha e diasporës dhe numri i vozitësve ka me qenë shumë i

madh, kështu që mundësisht të bëhen edhe vijat e bardha, për arsye se edhe kur është shoferi në mjegull, nuk po dihet orientimi në cilën rrugë je. Atëherë, kjo që e ka ngrit delegati është shumë e mirë dhe kisha pas dëshirë që këto përgjigje t'i marrë edhe nga kryetari.

Bexhet Xheladini: Sa i përket sigurisë në trafik, siç e dini, në komunë funksionon një Mekanizëm i përhershëm i sigurisë (KKSB), ku ne jemi të obliguar që t'i mbajmë gjashtë takime në vit. Ne deri më tash i kemi mbajtur dy takime dhe, në çdo takim, si pikë e veçantë e rendit të ditës është edhe siguria në trafik. Në këtë pikë vazhdimisht raporton komandanti i Stacionit Policor në Dragash, ku jep statistika se çka ka ndodhë brenda dy muajve. Është mirë që të mos ndodhin fare ndeshje, të mos ndodhin fare lëndime, ruajna Zot edhe vdekje nga komunikacioni, por megjithatë ato po ndodhin. Por, jemi ndër komunat që kemi më së paku këso raste. Por kjo nuk do të thotë që ne nuk duhet të diskutojmë që ne mos të kemi fare. Është e mira e të mirës që të mos kemi fare as ndeshje, të mos kemi edhe aksidente etj. Në çdo takim ne marrim qëndrime për evitimin dhe për minimizimin apo zvogëlimin e aksidenteve në komunikacion. Këtu u bënë edhe propozime me vend. Sa i përket rrugëve lokale, vendosjes së shenjave, e sidomos afër shkollave, që është kompetencë e Komunës dhe Komuna duhet ta bëjë një gjë të tillë. Por, sa i përket rrugëve magjistrale, Komuna nuk ka aso kompetenca, as për vendosjen e shenjave, as shenjzimeve dhe as të vendosjes së policëve të shtrirë, ose pengesave për kufizimin e shpejtësisë në rrugë. Aty ka të drejtë vetëm qendra, unë kam bisedue shumë herë me përfaqësuesit e Ministrisë, por ata nuk lejojnë një gjë të tillë. Sa u përket dritave në Pllavë, ne i kemi vendos dritat, ato një kohë kanë punue, tash nuk punojnë, për arsye se nuk ka qenë e vendosur ora. Ka disa muaj që ne e kemi bërë kërkesën prej KEDS-it me e vendos orën, ata ende nuk e kanë vendos. Është kompetencë e tyre dhe nuk e kanë vendos, si të vendoset ora edhe dritat do të lëshohen. Të thashë, rrugë lokale janë ato, është kompetencë e Komunës, ne duhet të bëjmë – jo vetëm të shkolla e Zgatarit – në të gjitha vendet ku ka nevojë dhe na lejon ligji me vu shenja, me vu ndalesa, ne mundemi edhe do të angazhohemi në këtë drejtim. Faleminderit!

Driton Ademi: Kryetar, siç thaj edhe vetë, ne i mbajmë gjashtë takime të KKSB-së në vit. Atëherë, nëse ka mundësi, një takim – ose bën edhe në seancën e rregullt, por edhe të jashtëzakonshme – me e ftue komandantin e Policisë edhe këta mekanizmat të cilët janë për siguri, që ta kemi me na dhënë edhe neve një raport, se nga ky Kuvend është votue KKSB-ja. Po raport po na jep me letër, kryetar, ne mundemi me ia dhënë edhe një rekomandim. Masi është edhe komandanti i Policisë aty, na mundim me ia dhënë një rekomandim. Për shembull, rekomandimi që munden me qenë më i vlefshëm: prej rrethit të Kapres e deri në Zaplluxhe, është shumë normale që të jetë patrulla e policisë, të ketë më të shpeshta. Se po ka më së shumti aksidente dhe lëndime në këtë rrugë. Besoj se ty nuk mund me të kushtue kurgjo, ose ne si Kuvend mundemi me e dërgue një kërkesë edhe me e ftue komandantin e Policisë në seancën e radhës, ose kurdo që ta shihni ju të arsyeshme. Nuk është e thënë që vetëm prej

Blaçit ose të Bresanës, munden me ardhë edhe të fshatrave tjera. Kryesore, qajo rrugë është me e frekuentume, që po ka probleme më së shumti. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Ne dy herë në vit i raportojmë Kuvendit. Atë raport ju lexone, i keni krejt statistikat. Në çdo raport, sikur qysh ke diskutue sot, ke mund me u çue me diskutue në raportin e fundit që e kemi dhënë, me i lyp këto, edhe unë në mbledhjen e dytë të KKSB-së e kisha paraqit këtë kërkesë.

Arijeta Skeraj: A do dikush tjetër? Në qoftë se jo, atëherë kalojmë te pika e nëntë: Eventuale.

Nexhat Selaj: Para se të filloj me këto të cilat i kam përpilue bashkë me qytetarët, në një seancë të mëhershme kam kërkuar që nënshkrimet e asambleistëve të cilët nuk janë prezentë të kryhen në fund, e jo në fillim. Këtu, nga të gjithë kolegët e mi që janë - nga 27 - prezentë s'po di a kemi edhe kuorum, nuk jam i sigurt. Kështu që, bëj një thirrje te kryesuesja dhe te kryetari, që të mos vazhdohet në mënyra të tilla, që të vijmë kolegët vetëm të japin nënshkrimin edhe të ikin. Të mos vijmë kolegët që vetëm partia në pushtet t'i miratojë këto pikat dhe të ikin një nga një nga salla. Zëri i qytetarit për të cilin ne jemi sjellur këtu është pika eventuale. Se pikat të cilat caktohen nga ekzekutivi veç i kanë gishtat edhe mund të kalojnë. Do të kaloj – pavarësisht se nuk i përkas fushës së shëndetësisë, por drejtorin pothuajse asnjëherë nuk e shoh këtu. Në mungesë të tij, sigurisht se kryetari, edhe është vetë mjek, do të na japë pak sqarime. Nuk është kjo kërkesë e imja direktë, por e qytetarëve që vjen nga disa lokalitete. Atëherë unë jam interesue dhe kam vështruar se kërkesa e tyre është shumë reale. Do të filloj nga AMF-të në Blaç, Kosavë, Kuk, Radeshë, Gllloboqicë dhe Vranishtë. Nuk kemi mjekë, kemi vetëm teknik të cilët punojnë aty. Jam interesue, kam shique edhe udhëzimin administrative 04/2020 – Kujdesi Përësor Shëndetësor, Neni 5, Pika 13 thotë se infermieri/ja në AMF aplikon terapi dhe vaksinim vetëm në prezencën e mjekut familjar apo të doktorit, mjekut. Ne me sa dimë, nëpër këto qendra, nëpër AMF – ambulanta, jepen edhe injeksione pa prezencën e mjekut. Kryetar, po nëse na ndodh neve ndonjë fatkeqësi – ruajna Zot – kush merr përgjegjësi për këtë? Në tubimet elektorale të cilat ju i keni mbajtur deri sa erdhët në pushtet, keni premtuar se këto AMF do të kenë edhe mjekë. Ju duhet të jeni karshi qytetarit, jo ta sillni një qytetar nga Blaçi, nga Kosava, në Dragash për ndonjë mjekim të sëmundjeve të ndryshme. Çka është më e keqja, pavarësisht se këto punojnë në mënyrë joligjore, se nuk ka mjekë, ne bëjmë edhe investime. Në secilën ambulantë bëjmë investime, në të cilat ne aty nuk kemi mjekë. Një e pakënaqur vjen nga fshati Pllavë – pak më parë u diskutua – janë dhënë rreth 9200 euro për ndriçimin e rrugës Pllavë – Tyrbe. Aty nuk punon asnjë llambë ndriçuese. Çka është edhe më e keqja, ma çon mallin sikur ne po dojmë me hy në Evropë edhe me u civilizue, edhe me ec para – prej shtyllës në shtyllë bartet rryma me ata telat sikur të viteve 50-ta, kur i varshin ato rrobat nëpër tela për terje, etj. A nuk është turp që të jepen 9200 euro edhe bartja e rrymave të bëet në mënyrën më të thjeshtë të mundshme. Këtu e paskam shokun Qamil – pa rezervë – nuk e paskam drejtorin e Administratës. Ka plot një vit, Qamil, që kemi diskutue për rrezikshmërinë e rrugës në fshatin Zym. Ishit vetë prezent, me

drejtorin e Administratës, edhe e patë se një investim shumë i vogël – se nuk jemi ne eksperta që të vlerësojmë sa do të kushtojë – po e patë ju se kishte 50 metra rrugë përgjatë rrugës kryesore, që t’i hekim ata ujëra të zeza, që mos të dalim në rrugë. U bënë një vit, e ju e futet në atë projektin e investimeve të shpejta. A një vit duhet me prit për një investim të shpejtë? Tash direkt do ju drejtohem juve, se bashkë kemi qenë aty. Edhe nëse ne presim që të investojmë, nëse na ndodh ndonjë fatalitet, se nuk bëhet më pyetje për aksidente. Në momentin kur unë kam raportuar para një viti, kanë qenë pesë aksidente. Nga ajo kohë deri më tani, kemi edhe shtatë tjera. Këto raportet mund t’i shiqoni edhe në Stacionin e Policisë. Intervenim i shpejtë ishte stadioni i fshatit Blaç. U bënë dy vite, sa që këtu na prutë edhe KF “Opoja”, ndoshta keni pas një qëllim tjetër, se ne nuk do ta votojmë e që t’i bindni ata se kush është kundërshtari i juaj. Ndoshta, po them – më falni – ndoshta mund të gaboj. Ndoshta i keni sjellë këtu që ata të binden, të shohin se ne e kemi seriozisht. Kryetar, nga 27 asambleistë sa ishin, po më duket 30 vetë kemi votuar që Klubin Futbollistik “Opoja” dhe stadionin në Blaç – që unë kam thënë në atë kohë do të jetë stadioni i Blaçit, jo i Opojës, por prapë po them stadion i Opojës – shtim investime dhe para tri a katër dite ishim aty bashkë disa kolegë, vërejtëm se nga ana e epërme ka fillue i tërë dheu të rrëshqet. Ne investojmë në ato vende – nuk po them që është shpërlarje parash, se nuk jam ekspert që të vlerësoj dhe të shoh a ka shpërlarje aty apo jo – por ne po shohim se rezultate nuk po ka. Investimi i shte i shpejtë, i domosdoshëm, u bënë dy vite e gjysmë! Prioritare, numër një, kryetar, keni pas edhe nëpër tubime, se Liqenin e Breznes – njëra prej atyre bukurive të rralla që ka, jo Kosova, por unë i përkas kësaj fushe edhe këso Liqen relikto nuk kemi fare në Ballkan. Ju keni premtuar se do të investojmë dhe do të sjellim turizmin në atë fshat, pikërisht në Liqen. Unë nuk shoh se kemi lëvizje aty, as në vitin 2023, as në vitin 2024, po nuk e di në planin zhvillimor 2025 a është a s’është. Çka është ma e keqja, ajo hapësirë vetëm po degradohet, po shkatërrohet, e jo që të rregullohet ose të mirëmbahet. Unë kisha kërkuar nga ky Ekzekutiv, nga këta kolegë, që të gjithë t’i kenë prioritet - të gjitha këto që i folën pak më parë kolegët zënë vend – por investimet në Liqenin e Breznes ju kisha lut, tash edhe noshta si ekspert i kësaj fushe, ta ruajmë bashkërisht dhe të investojmë në Liqenin e Breznes. Faleminderit!

Jetmir Ajdini: Atëherë, një çështje tjetër të cilën do ta ngris është pjesa e Gjermanit në Zagatar. Në hyrje të Gjermanit ka fillue të bëhet një deponi ilegale, qytetarë të pandërgjegjshëm hedhin mbeturina aty. Është bërë goxha shumë një degradim i ambientit aty. Do të kërkoja nga kryetari, me mjetet që i ka Komuna, ose edhe në bashkëpunim me “Ekoregjonin”, të bëjë largimin e atyre mbeturinave edhe pastrimin e asaj hapësire, që qytetarët të mos hedhin mbeturina aty. Tjetra – Gjermanin e dinë të gjithë si qytetarë të Dragashit që vizitohet shumë prej turistëve, vizitorëve të ndryshëm. Këmbështëpizat të cilat i ka ndreq qeverisja e kalume janë shkatërrue pothuajse të gjitha, është për keqardhje. E di që kryetari tash nuk ka kohë me dalë te Gjermani edhe me e pa atë pjesë, po e kisha lut një ditë veç me dalë me e pa, që ka nevojë për me investue, ose me i riparue, ose me i bo të reja ato këmbështëpiza.

Është një pjesë që frekuentohet shumë prej qytetarëve, është një pjesë e bukur e Komunës sonë që është mjerim me e lënë në atë gjendje. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Para pak ju kam dërguar disa fotografi në grupin e kuvendit komunal në viber, nuk e di nëse i keni parë. Ne nuk kemi mundësi teknike për t'i shfaqur ato pamje në projektor këtu, por bëhet fjalë për investime kapitale, ku gjatë asfaltimit të rrugës në Restelicë ka ndodhur rrëshqitja e dheut dhe një person nuk mund të hyjë normalisht në shtëpinë e tij dhe të jetojë. . I kërkoj presidentit që të urdhërojë autoritetet e tij që ta rregullojnë këtë problem sa më shpejt, në mënyrë që qytetarët tanë të përdorin shtëpitë e tyre dhe të jetojnë pa ndërprerje. Ky kuvend këtu votoi për një komision për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave. Ka kaluar afati i atij komisioni, ka kaluar mandati, në fshatin Restelicë keni ende një ushtrues detyre, a do të formojmë komision dhe kur do ta formojmë komisionin e radhës dhe si mendoni se do ta zgjidhni. Do të doja që të më jepni një përgjigje adekuate. Në seancën e kaluar nuk keni qenë i pranishëm këtu kur kemi diskutuar për blerjen e autoambulancave për qendrën e mjekësisë familjare në Dragash. Diskutuam blerjen e autoambulancave për qendrën e mjekësisë familjare në Dragash, nuk e di a e dini se drejtori juaj, zoti Behar Brenoli, drejtori i shëndetësisë, ka blerë një automjet të prishur me paratë e qytetarëve të kësaj komune. , ka ardhur këtu për këtë foltore dhe vetë e ka pranuar, të gjithë këtu në këtë sallë janë dëshmitarë të mi, njeriu tha se vetura e prodhuar në vitin 2021 shkon vetëm në drejtim të Prizrenit dhe ndalon mbi Zur. Ju te gjithë ju kujtoni fjalet e tij kolege ketu qe e ka thene vete, pyes veten nese automjeti eshte blere i ri pse nuk i keni bere reklame furnitorit qe ka sjelle nje automjet te prishur dhe pse nuk eshte nderruar ai mjet, e dime te gjithë. këtu kur blejmë një celular të zakonshëm kemi të paktën gjashtë muaj garanci dhe automjetet janë të garantuara deri në shtatë vjet. Për shkak se ai veturë nuk është kthyer dhe është sjellë një veturë adekuate në qendrën e mjekësisë familjare , e cila do t'u shërbejë qytetarëve të komunës sonë. Replika e Behar Brenolit më bëri të bëj më shumë kërkime. Sepse sipas raporteve që keni sjellë në këtë kuvend, zoti Behar Brenoli tha se në vitin 2021 ka blerë tre automjete për qendrën e mjekësisë familjare dhe në vitin 2022 dy automjete të tjera, nga të cilat katër janë autoambulanca dhe një automjet përdoret për dializë. Së fundmi kemi pasur mundësinë të shohim mjetin që përdorim për dializë. Ne ishim duke vozitur kolegët në një seminar dhe nuk kam asnjë kundërshtim në këtë drejtim. Megjithatë, zoti President, më intereson se ku janë ato katër automjete. Sipas raportimeve që Behar Brenoli solli në këtë kuvend, nga viti 2021 dhe 2022 duhet të kemi pesë automjete jo më të vjetra se tre vjet. Nga ato pesë automjete duhet të kemi katër autoambulanca, një ambulancë e dimë se ku është, kjo është e prishur dhe shkon vetëm përpjetë, ambulanca tjetër kemi pasur mundësi edhe nga media të shohim se është caktuar për ambulancën. qendër në Reselicë, por unë dhe besoj edhe juve, të dashur kolegë dhe qytetarë të kësaj komune janë të interesuar të shohin se ku ndodhen fizikisht ato katër autoambulanca. Në raportet që kam pasur

rastin të lexoj, shkruhet se janë blerë automjete me pajisje të plota mjekësore. Prandaj po ju kërkoj President, po ju lus zonja kryetare e Kuvendit, nënkryetarja e Kuvendit dhe kolegët tuaj që të shkoni dhe t'i shihni fizikisht ato automjete dhe të shihni se çfarë lloj pajisjesh mjekësore kanë ato automjete. ato. Sepse më besoni, kohëve të fundit ka pasur një situatë ku e kanë bartur një pacient nga vetura në veturë duke e transportuar për në Prizren. Kjo është e papranueshme, ju thashë mund të llogarisim me gjithçka, por me shëndetësi nëse fillojmë të luajmë kështu, në komunën tonë nuk na mbetet gjë tjetër veçse të shtypim atë buton atje dhe të fikim rrymën në të gjithë komunën, jo vetëm ndërtesa e qendrës shëndetësore. Gjëja e tretë, zoti President, ju keni rinovuar shumë në qendrën shëndetësore të Dragashit. Megjithatë, nuk shoh që qendra shëndetësore të ketë kushte teknike për personat me aftësi të kufizuara. Për shembull, një burrë i palëvizshëm, i cili është në karrocë, a mund të shkojë te dentisti në qendrën shëndetësore të Dragashit. Si mund të bëhet. Prandaj zoti President e shoh sot që nuk ke asnjë nga drejtoret këtu, me dashje apo pa dashje, nuk do të hyj në këto, por pres që të më japësh përgjigje cilesore dhe pres nga ju. të na ftojë nga kuvendi të shohim ato pesë makina. Ku janë ato pesë makina?

Bexhet Xheladini: Sa i përket ndëshkrimit të asambleistëve në fund të seancës, ajo është çështje e juaja dhe në seancën e ardhshme, në fillim të seancës, debatonim edhe merrni vendim. Konultoheni edhe a është kjo ligjore apo jo, nuk e di, por ju merreni vendim, është ky vendim i juaji dhe unë s'kam pse mos me e përkrah ose me e kundërshtue. Ju thatë që në fushatë elektorale kam premtu që nëpër AMF do të ketë mjekë. Unë nuk kam premtue, unë krejt çka kam premtue në shëndetësi, i kam realizue. Në Pllavë ndriçimi, e dhashë përgjigjen, kemi bërë kërkesën në KED me e vu orën, në momentin kur të vendoset ora do të lëshohen dritat. Thatë që është bërë një intervenim i shpejtë për ndërtimin e stadionit në fshatin Blaç. Ky ka qenë një projekt dyvjeçar dhe investimet të cilat i kemi paraparë ne dhe kemi premtue që do t'i bëjmë, ne i kemi bërë. Investimet që cilat ka pas me i bo komuniteti, nuk i ka bo. Mirëpo, pse nuk i ka bo komuniteti nuk do të thotë që ne nuk do t'i bëjmë. Ne do t'i bëjmë, do të bëjmë përpjekje dhe do ta kryejmë edhe stadionin e Blaçit. Në Zym, me sa e di unë ata ujërat e zeza i kemi rregullue, mirëpo këtë problem të tjetër ku ka qenë në terren Qamili edhe Vetim, më duket – unë nuk kam qenë këtu, kam qenë jashtë shtetit, nuk e di – ne e kemi shpallë tenderin, po ka dështue tenderi vitin e kaluar. Nuk ka pas asnjë kompani të interesuar me e bo këtë punë, por ne këtë vit do ta bëjmë. Te Liqeni i Breznes ne jemi duke investuar dhe do të investojmë. Tash e kemi një investim diku afër 70 mijë euro, ku do të bëhet një kënd i lojërave të fëmijëve dhe një rregullim i infrastrukturës përreth Liqenit. Tenderi është shpallë, fituesi është zgjedhë, është nënshkruar kontrata dhe pritët fillimi i punimeve. Sa i përket deponisë në Gjerman, jam i njoftuar për këtë. Nuk është vetëm ajo deponi, ka edhe deponi tjera në të gjithë territorin e Komunës së Dragashit, sepse është papërgjegjësi e jona edhe e atyre të cilët e i gjuajnë. Ne duhet ta bëjmë një zgjidhje. Sot kam marrë një vendim që së pari të

shpallim tenderin për vendosjen e 50 tabelave, ku shkruan “Ndalohej hedhja e mbeturinave!”. Ata të cilët do të zihen, do të gjobiten edhe do të sanksionohen me ligj. Po ashtu, pas vendosjes së këtyre tabelave, do të marrim iniciativë që këto deponi ilegale t’i mbyllem. Ne e dimë që kjo Asamble ka votue për me i hap dy deponi për mbetje të ngurta në nivel të Komunës. Vitin e ardhshëm besoj që do të fillojmë ndërtimin e këtyre dy deponive. Për këmbështëpizat në Gjerman, ne ndajmë mjete financiare për çdo fshat, është mirë që fshati, kur t’i bjer kërkesat, njëra prej këtyre kërkesave të jetë edhe kjo. Problemi në Restelicë, për atë hendekun që po thotë, është e vërtetë që vitin e kaluar, kur janë krye punimet nuk është ndërtue ai muri. Për atë edhe ato mjetet janë kthye në suficit. Ne kemi ndarë mjete të mjaftueshme sivjet, për ndërtimin e këtij muri, është tenderi i hapur për këtë. Zotëria që e tha këtë, e ka dëgjue don me e marrë si farë merite që ai ka ndikue që ne kemi vendos për me e krye atë punën e atij hendekut. Sa i përket Komisionit për zgjedhjen e drejtorit, atij nuk e di a i ka kalue mandati apo jo. Nëse i ka kalue, Asambleja Komunale do ta zgjedhë tjetrin. Për shkollën e Restelicës do të shpallet tjetër konkurs për emërimin e drejtorëve, për arsye se konkursi i parë ka dështue. Sa i përket pretendimit se Behar Brenoli ka ble një automjet të ri dhe ai ec veç teposhtë e jo përpjetë, unë këtë për herë të parë po e dëgjoj dhe jam 1 milion përqind i sigurt që ne, si Qeveri Komunale, qaso automjete nuk kemi ble. Nëse është blerë ai automjet para vitit 2022, nuk e di, as për atë nuk po them. Por dua të them vetëm diçka: Vetëm pesë automjete të ndihmës së shpejtë janë në terren, tri janë në pjesën e Gorës dhe dy janë në pjesën e Opojës. E mos të flasim në QKMF-Dragash, që ka mjete të mjaftueshme, ambulance të mjaftueshme, edhe nuk ka vetëm pesë por ka edhe më shumë se pesë, edhe të gjitha janë në funksion dhe të gjitha ecin. Është krye edhe servisimi i të gjitha automjeteve të ndihmës së shpejtë, të gjitha janë në funksion dhe të gjitha i kanë pajisjet në vend. Nëse nuk beson dikush, formone një Komison pre këtu, tash, hiç ma vonë se tash mundeni me shkue me e vërtetue. Por në Komision le të vendoset edhe një vozitës. Sa i përket asaj se a mundet një person me nevoja të veçanta me shkue të stomatologu, kjo është vërejtje me vend edhe ne duhet të punojmë për këtë.

Nexhat Selaj: Faleminderit edhe një herë të gjithëve! Faleminderit do t’u drejtohem qytetarëve, se kur nuk ke guxim edhe kur nuk ke aftësi të mjaftueshme që të përgjigjesh, e lëshojsh edhe vendin se ku e ke. Të paktën kryetarit, aspak kurrë s’e kam mendue që në mënyrë të tillë detyrohet të dalë nga salla. Burrë është ai i cili u qëndron edhe punëve të liga, jo vetëm punëve të mira. Asnjëherë nuk e kam kundërshtue, kur janë bërë punët e mira gjithmonë e kam lavdërue edhe do ta lavdëroj edhe në të ardhmen. E kuptoj unë pse u largue, se e preka në profesionin e tij, në shëndetësi, në AMF. Qytetarët le ta dinë, le ta din edhe opinionin të gjithë, infermierët paguhen, mjekë nuk ka. Thotë nuk e kam përmend në elektorat. Nëse nuk e ke përmend në elektorat, pse investojmë në AMF. Në Blaç, Kosavë – këtu e kemi z.Qamilin – çuam me dhjetëra e mijëra euro, nuk është funksionale. Këtu duhet të jetë kryetari edhe të japë sqarime. Në Radeshë po ashtu, në Gilloboqicë po ashtu, në Vranishtë me dhejtëra e mijëra

euro. Nëse ne e shikojmë, për këto dy vite e gjysmë kemi ndarë mbi 80 mijë euro investime të kota, të hedhura poshtë, para të qytetarëve. Deklarohet kryetari, kur t'i vendosin kutiat e orës, atëherë do të rregullohet ndriçimi publik. Unë pajtohem me atë, por kush i nënshkroi 9200 euro punët të cilat janë kryer? Montimi i orëve është punë e fundit. Janë montuar shtyllat dhe telat barten shtyllë më shtyllë. Kjo është një primitivizëm, kjo është e kohës së Bangladeshit. Ma çon mallin sikur ata filmat në Bangladesh ashtu si i shohim, kështu e kemi ne ndriçimin. Duke raportuar për tek ndriçimi publik na Pllavë, të paktën kam dhjetë mesazhe që vijnë nga qytetarët e fshatit Pllavë, kërkojnë nga kryetari – po që s'po ka guxim të rrin edhe ikën kështu, që nuk dëshiroj tjera herë ta shoh në një pozitë të tillë – thoë ç'po bëhet me atë liqen në Pllavë, liqenin artificial. Vonë e kuptova se ishte fjala për stadionin. Të gjitha tenderët të cilat kanë kapital, vlerë të lartë, nga kjo qeverisje dalin në gusht ose në shtator. Vetëm përzihet pak puna e tenderit, edhe vazhdon vitin tjetër. Çfarë i kemi bërë ne fshatit Pllavë në këtë moment, e kemi shkatërruar një fushë, një gjelbërim, kemi ndërtuar, kemi ndreq, kemi hapur një liqen artificial, për tanë dimrin, tanë vjeshtën, dimrin dhe pranëverën është bart balta në rrugë, dhe tash ka mbet si e tillë. Po kryetari e ka vendin këtu që të japë përgjigje. Thotë po investojmë në Liqenin e Breznes. Unë nuk kam parë projekte gjatë periudhës 2023-2024 që do të investohet. Për në fshatin Zym, thotë e kemi qit ne tenderin, është kthye prapë. Një vjet është bërë bre – Qamil, të lutem, si shoq – mos të na vjen deri te një fatalitet, se për çdo ditë vetë e ecish atë rrugë. Të isha lut si shoq, të isha lut si koleq, të isha lut si asambleist, të isha lut si asambleist që e kam marrë votën e qytetarëve dhe të mbrojmë qytetarin. Thotë kemi investue në fshatin Blaç. Vetëm kemi hudhë pare ne fshatin Blaç, në stadion. Investim i shpejtë, urgjent, kanë mbet lojtarët, po maltretohen, këtu kemi dëgjue ne një mori bisedash, të gjitha kanë qenë biseda konstruktive në kohën kur ne kemi folur, në atë kohë. Shkuan dy vite e gjysmë, ato para – sa janë nuk e di, më duket janë 50 mijë euro vetëm që i kemi gjujt, edhe asgjë tjetër nuk është bërë. Unë i drejtohem qytetarëve, që ne nuk kemi qeverisje, më vjen keq. Nuk kemi asnjë drejtor këtu prezent, që krejt puna është e drejtorëvem unë duhet të lypj – nëse nuk është kryetari, që mund të jetë i zënë, mund të ketë takim, e kuptoj, por këto përgjigjet mua më duhet t'i marr nga drejtorët. Të përgëzoj, Qamil, që je non-stop këtu, na informojsh, s'po them mirë ose keq, por e guximin që të rrish edhe të na japësh informacion. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Në seancat e fundit kemi bo përpjekje t'i ikim retorikës politike dhe gjithmonë jam mundue të ju jap fakte konkrete. Por realisht, duke dhënë fakte dhe duke u mundue me i ik politikës, këtu po dalim se po bëhet politikë. Profesori Nexh, unë kam respekt për punën të cilën e bën në aspektin profesional, por kur del jashtë profesionit ka disa sende që duhet të kërkosh sqarime. Ju duhet ta dini se KAB-i parashihet nga Qeveria e RKS-së. Qeveria, prioritet në investime kapitale i ka dhënë arsimit dhe shëndetësisë. Pavarësisht pse kemi rënie të numrit dhe të numrit të arsimtarëve në arsim, Granti Specifik në arsim ndahet nga Qeveria, drejtpërdrejt në arsim. Dhe realisht, mjetet të cilat ndahen për

investime kapitale në arsim dhe në shëndetësi, nuk mund t'i destinosh në investime tjera kapitale. Sepse Qeveria dhe Ligji për Menaxhimin e Financave ka një rregull, se është ligj dhe është më i madh sesa Ligji për financimin lokal. Në shëndetësi, ju mund të thoni se çka po ju duhen investimet, edhe pse kemi investue dhe nuk do të ndalemi së investuari. Sepse janë të parapara mjetet për investime kapitale që janë kryesisht në infrastrukturë, nëpër të gjitha ambulantat. Pavarësisht se ne jemi duke e ditë se nuk kemi mjekë, qysh nuk kemi nxënës nëpër shkolla, të njëjtën situatë e kemi të mjekëve në Komunën tonë. Kemi mungesë të mjekëve, por investimet derisa janë prioritet dhe derisa janë të parapara në KAB, nuk kemi mundësi të i orientojmë në drejtim tjetër. Sa i përket rrugës, unë mendoj se shumë i qartë ishte kryetari, dhe ti e dish që, përpos asaj rrugës në Zym, ne kemi intervenue edhe në projektin pak më tutje, edhe e kemi zgjidhë, po kemi pas kompani që e ka marrë ndërtimin e kanalizimit në Zym, po nja 100-200 metra më tutje, kah Laki i Pulës, dhe ia kemi arrit qëllimit. Prifesor, sa i përket stadionit, nuk është mirë me bo politikë as na e as ju. Ai ekipi, ata djemtë janë të Komunës sonë. Pavarësisht emocioneve të tyre, që kur kanë ardhë – na i lëshoni veç 40 mijë euro, dhe qetu në Kuvend e kemi prurë këtë – na i lëshoni veç 40 mijë euro se po na kushton neve shumë transporti, dhe pjesën tjetër të investimeve do ta kryejë komuniteti dhe do ta kryejë donatori, me gjëra megalomane. Edhe pse unë kam qenë shumë skeptik se me qato 40 mijë eurot nuk bëhet kurgjo, e lë mo një stadion. Përkundër asaj, kur kemi çue inxhinierat tonë edhe e kanë mat atë stadionin, neve na kanë dalë vetëm heqja e dheut 40 mijë euro. Dhe ne kemi lëshue 90 mijë euro edhe e kemi krye pjesën tonë të punës. Ekipi është në atë gjendje në të cilën është. Nuk duhet të hyjmë të gjykojmë edhe të japim informacione sepse ata janë një ekip i konsoliduar, që kanë një kryesi, dhe ne i kemi ndihmue për aq sa i kemi ndihmue. Ne anën tjetër, ne ndajmë subvencione për mbulimin e shpenzimeve të këtij klubi dhe jemi duke i mbulue të gjitha këto. Prandaj nuk kemi qenë të pajtimit – se kanë nis në mënyrë euforike, e kemi ditë, por aq sa kanë kërkue prej Komunës, ne i kemi kryer obligimet. Tash është çështje krejt tjetër kur e marrish rolin e inxhinierit, e unë nuk kam të drejtë atë me e marrë, se unë jam veç një ekonomist, unë e di se i kemi lëshue parat, i kemi ndejt në parim marrëveshjes, memorandumit e kemi krye. Në aspektin inxhinierik, në qoftë se ti si gjeograf je inxhinier, unë nuk mund ta marr atë të drejtë, edhe t'i vlerësosh në aspektin inxhinierik, atëherë thirrë menaxherin e atij projektit, munden me të dhënë përgjigje, në aspektin inxhinierik nuk kam përgjigje. Sa i përket Liqenit të Breznes, qeky Kuvend – profesori Nexh, ndoshta je prej delegatëve më të ri – po qeky Kuvend e di se Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi Komunal i Dragashit, ekziston ende një vendim që është i ndaluar ndërtimi. Ne kemi pas disa kërkesa prej donatorëve që t'u jepet në shfrytëzim që të bëjnë investime – sepse është një vend piktoresk, është i mirë dhe është mirë me e aktivizue – po pikërisht sepse po i njëjti vendim është ende në fuqi, që nuk lejohen ndërtime, përderisa ky Kuvend edhe Qeveria e Kosovës nuk e shfuqizon atë vendim – e ke në uebfaqe të Komunës – nuk mundish me bo veprime të cilat ne mendojmë se mund t'i bëjmë. Çështja e

stadionit të Pllavës edhe ndriçimit të Pllavës, ju shumë mirë e dini që Këshillat e fshatrave edhe fshatrat na i bien neve në dëgjimet publike prioritetet e fshatrave. Unë kam qenë si përfaqësues, si kryetar i shtabit për diskutim publik në Pllavë që kam qenë kundër atij propozimi. Mirëpo, në prezencën tonë e kanë prurë që të bëhet ndërtimi i stadionit në Pllavë. Po e humbni imazhin e Pllavës, se Pllava njihet me pamjen e Kreveqicës. Ka qenë kërkesë e tyre, i kanë ndarë mjetet e tyre, e kanë filluar punën. A është e mirë, a është dinamika t'ua shkue në rregull, a s'është në rregull, ta bie menaxherin e projektit, mundish me u marrë me të, inxhinierë ne nuk jemi, Paratë që janë të parapara për kokë banori nëpër komunitete i kemi ndarë në mënyrën më fairplay të mundshme. Sa i përket ndriçimit, është çështje teknike, ne nuk mund ta marrim rolin e KEDS-it dhe ta vëmë orën. Në momentin që vihet ora edhe bëhet pranimit teknik, në qoftë se nuk funksionojnë prapë nuk e bën kryetari, as drejtori i Ekonomisë, as delegatët nuk e kryejnë atë punë. E kryen kompania e cila është kontraktuar dhe është paguar për me qenë funksionale qato dritat. Prandaj, nuk ka nevojë t'i zmadhoni gjërat të cilat janë shumë të thjeshta. Secila pjesë e punës që kryhet e ka koston e vet, çdo kosto e ka dikush që i merr paret dhe duhet me e krye qat punën. Tash me të thënë unë ka me u bo edhe s'ka me u bo, ose me të thënë kryetari, e shtish me harrue profesionin e vet prej doktorit edhe me u bo inxhinier. Në këtë rast me Pllavën, duhet me u bo edhe inxhinier i energjetikës. Mos lyp gjëra që s'munden me u bo. Prandaj, unë po due me qenë shumë i sinqertë, edhe në pyetjet edhe në bisedat, unë ju jap të drejtë, jeni parti opozitare, keni nevojë për me bo politikë, po edhe politika duhet të bëhet në suaza të realitetit edhe të mundshmes.

Nexhat Selaj: Faleminderit, drejtor i Financave! U mundove që të nxirresh pak, pavarësisht se edhe duhet të nxirresh. Nuk e pashë se ku bëra politikë. Nëse është politikë të investosh në mënyrë të gabuar në AMF, Blaç, Kosavë, Kuk, Radeshë, Glloboqicë, Vranishët, mbi 80 mijë euro, unë nuk e kuptoj se është politikë. Ndoshta ne bëjmë politikë, po bëjmë politikë të qeverisjes, nuk bëjmë politikë partiake, kjo është politikë e përgjithshme e tatimpaguesve, e qytetarëve të Komunës sonë të cilët lypin shërbim. Nëse ty të duket se ne po bëjmë politikë, është diçka tjetër. Thatë se paratë në shëndetësi alokohen nga Ministria për Shëndetësi. A s'kemi mund ne me i alokue diku tjetër, po me i çue në AMF me i bllokue ato para. Kur ne e dimë – se unë nuk deshta të kyçem shumë – se ne deri dje s'kemi pas rëntgen, i kemi çue qytetarët nëpër Prizren i kemi shëtiti. Deri tash u diskutua për ato autoambulancat, se unë nuk i kam pa, nga kolegët dëgjova, asnjë nuk është stabile, ecin 30-40 km/h, nuk e di atë, a janë të vërteta a s'janë nuki di. Nëse të duket kjo se është politikë, atëherë unë seriozisht po bëj politikë. Folëm për ndriçimin, u mundove që të arsyetohesh, shumë në rregull. 9200 euro – Qamil – janë lëshue, u dashtë me e pranue dikush atë punë. Është turp të nënshkruajmë 9200 euro punë nga punëkryesi, para të qytetarëve. Ndoshta duket se po bëj politikë, po para janë të qytetarëve. Bartet rryma me tel të thjeshtë, prej një shtyllë në një shtyllë tjetër. Kush e pranon këtë punë? Nga qeverisja, keni ju vetë ekspertët e juaj, nuk besoj se jemi duke bo politikë. Tek stadioni në Blaç, thajë 40 mijë euro, shumë në rregull, kush nuk e

ka kontestue këtë. Nuk është politikë, shoku jem Qamil, 40 mijë euro janë dhënë edhe po mbulohen ato 40 mijë, çka të bëjmë bashkërisht që ta rregullojmë atë? Unë nuk po shoh se është politikë. Të Liqeni i Breznes, po thuhet se është nën ruajtje, krejt okej, por është premtue se do të përkujdesemi për atë Liqen. Të paktën, ne mundemi si Komunë, një aso autokombanjë të pastrimit, mund ta pastrojmë, të paguajmë katër a pesë punëtorë, ta pastrojnë. T'i joshim turistët, e jo t'i hekim nga aty. Mund të paguajmë, Komuna mund të marrë një vendim të paguajë një punëtor, ta mirëmbajë, ta pastrojë, e jo ta sjellë në gjermadhë sikur në vitet e '80-ta. Nëse unë kam bo politikë, më fal, unë nuk po shoh se është politikë. Kemi kërkuar në fshatin Zym që të kemi 50 metra një kanalizim, që të sigurohen ujërat e zeza. Nëse është politikë që ne dojmë të ruajmë aksidentet edhe ndonjë fatalitet, më fal, po bëj politikë. Është politikë e përgjithshme, politikë që t'i mbrojmë qytetarët edhe të punojmë bashkërisht. Faleminderit!

Uran Halimi: Po ndërlihdemi, meqenëse e kemi pikën e rendit të ditës eventuale, po flasim për eventualitetet. Përveç asaj pikës shumë të qëllime që z.Driton e propozoi këtu në seancë, kryetari tha që KKSB-ja po mban vazhdimisht takime, e andej vazhdimisht po ka telashe. Është fjale e aksidenteve, po se po, por edhe e përleshjeve mes të rinjve nëpër fshatrave, ku kohën e fundit ka pas edhe me lëndime trupore. Tentativa të ndryshme për prishje të rendit. Është mirë që kryetari, kur e takon atë komandantin e Stacionit Policor, me bo kërkesë të paktën në kohë të shkollave, kur fëmijët dalin nga shkollat, me pas ndonjë lëvizje të policisë, për me i parandaluar edhe shoferat e pakujdesshëm por edhe ata të rinjtë që ngucen mes vete, për shkak se munden me ardhë deri te ndonjë problem goxha më i madh edhe më i paevitueshëm mandej në fund. Te Këshillat e fshatrave, z.Kolloni, kam thënë edhe më herët, e kam edhe kërkesën që ma ka dërgu Këshilli i fshatit Blaç, në vitin e kaluar, për vitin 2023. Ne i kemi themeluar ata këshilla, pjesë e Komisionit kam qenë edhe unë, bashkë Samidinin edhe disa anëtarë të tjerë të Kuvendit. Ata janë këshilla vetëm për emër edhe për numër, mirëpo të papërfillshëm nga qeverisja. E kemi rastin te Këshilli i fshatit Blaç, ata veç një kërkesë e patën bo, për investim në rregullimin e kaptazhave të ujësjiellit – janë ata kaptazhat e famshëm që në dokumentacion i keni rregulluar ju – e keni edhe dokumentacionin ku e keni shpallë tenderin dhe e keni përfunduar atë tenderin, e keni nënshkruar si të pranueshëm, mandej jeni arsytuar që mbase nuk keni paguar për pjesën e punëve që s'janë krye. Nëse ju nuk keni paguar për pjesën e punëve që nuk janë krye, atëherë pse s'po e hapni një tender as në vitin 2023, po besoj që edhe qetash s'ka me u hap ai tenderi, për me e plotësuar kërkesën e vetme të Këshillit të fshatit Blaç. Për punë e stadionit kam diskutuar edhe më herët, ku kam thënë që drenazhimi i stadionit nuk është bërë me atë llaufin që i themi në gjuhën popullore, po është bërë me atë dheun që e kanë marrë atje nëpër gurishte, duke e shkatërruar ambientin edhe duke mos bërë kurrfaqë pune. Arsyja pse po flas në lidhje me këtë është që, mbase stadioni ka me u bo edhe po besoj që ka me u bo, se goxha i patëm dhënë zor, mirëpo edhe pas një viti e gjysmë edhe pas gati tri vjet të qeverisjes suaj, KF "Opoja" po vazhdon me paguar udhëtim edhe po vazhdon me luftë nëpër stadione të huaja. Krejt

Komuna jonë nuk e ka një stadion për me e mbajt një ekip që mezi po mbahet, ne nuk jemi në gjendje me i krijue kushte. Jemi në gjendje me ndreq parqe pa mirëmbajtje, të keqtrajtume, të shkatërrume, jemi në gjendje me ndreq edhe ambulanta – qysh tha profesori Nexhat – pa doktor edhe pa shërbime. E kemi rastin e Bresanës, ma herët u bë bum kur e morëm një vendim për rrënimin e objektit t'ëish-ushtresë serbe edhe rrënimin e objektit të postës, atë objektin e vjetër. Okej, ka qenë një vendim i mirëpritur nga qytetarët, mirëpo jo tash ato të shfrytëzohen si parkingje mbase edhe private. E kemi rregullimin e rrugës së qendrës në Bresanë, aty u prish ajo pjesa e trotuarit ku kanë kalue qytetarët, tash është t'u shfrytëzue si parking i bizneseve. Tjetra, njërën prej kërkesave që ma kanë bo qytetarët, se ata kanë vërtet nevojë, ndriçimi i asaj rrugës së fshatit Pllavë, ku më herët ka pësue një qytetarë, duke humbur jetën aty. Arsyetimi që nuk është ora elektrike, kjo nuk qëndron, se s'munden tenderi me u pranue pa pas orë elektrike. Më kanë thënë që disa ditë e kanë lëshue në funksion atë, sa me e pranue. Jo vetëm ky projekt, por shumë projekte komunale, të papërfunduara, janë pague vetëm e vetëm që kryetari pak më herët me dalë me thënë na e kemi bo realizimin e buxhetit diku 97%. Mirëpo 0% është realizimi ose përfundimi i atyre projekteve. E kie atje rrugën e Brrutit, që çon për Zgatar, e dimë na çfarë projekti është ai, i realizuet edhe i shkatërruet pa u përurue. Sot kalova nga fshati Brrut prej Zgatarit, që erdhëm këndej bashkë me Jetmirin, edhe më erdh shumë keq qysh mundin ata qytetarë me e përballue ecjen në atë rrugë brenda fshatit Brrut. Gjithandej me kanale të hapura, të pambyllura ato, po më vjen edhe keq, meqenëse delegati i ri është nga fshati Brrut, po më vjen keq që unë me folë në emër të fshatit të tij. Është mirë delegat, meqenëse të kanë votue shumica e atyre qytetarëve të fshatit Brrut, me dalë me e ngrit zërin për fshatin Brrut. Te rastet e rrugëve të shkollave që e përmendi z.Ajdini, kërkund s'ka trotuar, këkrund s'ka pengesa për ulje të shpejtësive, rrezikimi i gjithanshëm, vazhdojnë me u godit fëmijë, gati nëpër secilin fshat të Komunës sonë ka aksidente ku goditen fëmijët. Shyqyr Zotit s'kemi humbje të jetës, mirëpo është mirë me i evitue ato sa më herët. Më herët jam ballafaque edhe me znj.Skeraj, ku u detyrova me e lëshue seancën. Më akuzoi për një debat jashtë teme, nuk është hera e parë që kryetari edhe komplet qeverisja i kini kësaj pikës eventuale, mundohen mos me e shti në rend të ditës, janë mundue edhe unë kur kam qenë kryesor, hajt se s'na duhet, hajt se s'kemi kohë, hajt se trajnime. Mirëpo, kryesuese, kjo është arsyeja pse atë ditë më thaj me mos u merr me personale, mos del jashtë temës. Meqenëse s'po na ngon kërkush, na patjetër që duhet me reague. Ndonjëherë po na duhet edhe me dalë jashtë temës, e arsyeja pse dola jashtë teme në seancën e fundit ka qenë kjo, se kryetari pritke me ik te pika eventuale. Nuk është mirë me ik, duhet me nejt, për hatër të atyre qytetarëve që ju kanë nga mbrapa me jau marrë votat, e sot ikën përpara llogaridhënies. Faleminderit shumë!

Driton Ademi: Masi e kemi këtu drejtorin e Financave, një pyetje. Ndoshta munden me qenë në dijeni, pasi edhe i përket atij fshati. Drejtor, siç e dimë, prej fshatit Kosavë, Kosavë, Kuk, Buzez, Bresanë, Zaplluxhe dhe Blaç ju si qeverisje keni marrëveshje ose kontakte me KEDS-in. Ne si regjion, prej

Kosavës deri në Zaplluxhe, këto fshatrat jemi në hall me KEDS-in. Rryma ndalet, as vetë nuk e dimë, edhe qendrën kur e kontaktojmë, nuk kanë informata as prej qendrës çka me na thënë. Kishte qenë mirë një përgjigje, si qeverisje, me e pas prej jush, nëse keni naj informatë, se ju keni bashkëpunim me KEDS-in. Është mirë një informatë, me dalë para qytetarëve me ia dhënë, çka është problemi këtu, a është problem i një vendi a ku është problemi. Sidomos këto ditët e kemi pas shumë problem, se shumë shpesh kemi ndërprerje të rrymës elektrike. Edhe është mirë me reague edhe si qeverisje në organet kompetente të KEDS-it. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Të nderuar qytetarë, keni pasur rastin të shihni se si kreu i ekzekutivit po ikën nga përgjegjësia. Ai thotë se thashë atë që kisha për të thënë dhe e fshiva nga kjo seancë. Nuk i interesojnë protestat, nuk i interesojnë problemet, nuk i interesojnë shëndetësia, realisht nuk e di se si ka ndërmend ta zgjasë mandatin edhe për katër vjet. E di, të dashur qytetarë, që jeni të vetëdijshëm për faktin që keni bërë një gabim, por do të keni mundësinë ta korrigjoni atë gabim dhe të mos i mbështesni më këta njerëz në pushtet. Duke qenë se kryetari i komunës nuk është këtu, unë do t'ju drejtohem institucionalisht, sepse ndryshe nga ai , unë kam shumë më tepër besim tek ju se do të iniconi nismën dhe do të kontribuoni për të marrë disa përgjigje që ne si delegatë dhe përfaqësues legjitimë të zgjedhur në mënyrë demokratike. e njerëzve, meritojnë të dinë. Prandaj, zonja Presidente, dua t'ju lus që të iniconi iniciativën, së pari në këtë komunë për të parë se ku janë ato pesë vetura. Zoti kryetar tha se kemi shtatë, tetë, 10 vetura, e kuptoj që kemi 27 dhe 33 vetura konkretisht në pronësi të komunës së Dragashit, por jam i interesuar që fizikisht t'i shoh katër automjete mjekësore jo më të vjetra se tre vjet. Sepse në raportet thuhet se ato automjete janë blerë. Nuk më interesojnë automjetet 20-vjeçare Në raportet që kam marrë nga drejtori i shëndetësisë z.Behar Brenoli, të shkruara nga dora e tij, thuhet se ka blerë automjete në drejtorinë e tij. Një për dializë dhe 4 autoambulanca me pajisje të plota mjekësore. Unë dua t'i shoh fizikisht ato katër automjete si delegat, si përfaqësues i popullit, ku janë, si duken, të kontrolloj se çfarë gomash kanë, të shoh se çfarë pajisje mjekësore kanë brenda. A paguhen këto automjete me paratë e këtyre qytetarëve? Unë jam i interesuar se ku janë edhe ata zonja Presidente, unë besoj në ju dhe jam plotësisht i sigurtë kur e them këtë. Dhe po ju kërkoj të merrni iniciativën për të parë ato pesë automjete, ndoshta e kam gabim. Pak më parë Munir Jonuzi preku temën e projekteve të papërfunduara në Gorë dhe zhvendosjen e fondeve në Opole, sa për ta ditur, sot në Opoje ju dhanë fonde partia e Adema Hodza JGP dhe partia e zonjës Duda Balje.

Jetmir Ajdini: Kjo ikje e kryetarit prej debatit me asambleistë edhe prej pyetjeve të cilat ne ia parashtrajmë, unë e shoh si papërgjegjësi totale për shkak të mospunës së tij. Nuk ka ndonjë arsye tjetër pse me i ik debatit me asambleistë edhe pse me iu ik pyetjeve të cilat ia bëjmë na si të zgjedhur të popullit për shqetësimet të cilat i kanë qytetarët. Jo vetëm unë, po disa prej asambleistëve ia bamë disa pyetje konkrete kryetarit, për çështje konkrete, i morëm përgjigjet e tij që ishin përgjigje në kohë fushate

edhe premtime boshe. Për asnjërën prej pyetjeve të cilat ia bëmë nuk dha ndonjë zgjidhje konkrete. I bëra pyetje për policët e vdekur të cilët duhet të vendosen prej kryqëzimit deri të rruga e shkollës në fshatin Zgatar, kryetari më tregoi veç që është përgjegjësi e Komunës ajo, gjë të cilën e dimë edhe unë edhe të gjithë qytetarët, por nuk tha që do të marrë ndonjë veprim për atë pjesë. I bëra pyetje për deponitë ilegale, jo veç na Zgatar po i ka disa deponi ilegale, nuk dha ndonjë zgjidhje konkrete çka do të bëjë me ato edhe qysh ka me menaxhue këtë pjesë të deponive ilegale. E bëra një pyetje për këmbështëpizat të cilat janë në pjesën e Gjermanit, totalisht të demolue, kryetari tha që ato duhet të vijnë si projekt kur të ndahet buxheti për fshatin Zgatar. Edhe një herë i bëj me dije edhe kryetarit edhe krejt kësaj qeverisje komunale, që Gjermani nuk është vetëm i zgatarasve, Gjermanin e vizitojnë krejt qytetarët e Opojës. Njëri prej premtimeve të kryetarit ka qenë investimi në turizëm, nëse nuk është në gjendje me investue në atë pjesë, me e rivitalizue prapë edhe me i bo funksionale ato këmbështëpiza, edhe pret që me buxhet të Zgatarit të bëhen ato, unë e shoh total papërgjegjësi. Faleminderit!

Samidin Xheladini: Të nderuar delegatë, Kuvendi është organi më i lartë i Komunës, edhe ne kemi të drejtë punët tona me i krye me përgjegjësi dhe kërkush s'un na mohon me formue ne komisione, ose me shkue në terren edhe me e shfaq me argumente gjendjen ne terren. Kjo është detyrë e jona. Kryetari dhe ne jemi të zgjedhur prej popullit. 28 persona janë të zgjedhur prej popullit. Ne duhet t'i bëjmë punët tona. E kemi formue një Komision – ka pas dyshime se asambleistët nuk i kanë marrë pagat si u takon me ligj. Ai Komision nuk është duke funksionue. Ish-Kryesusi nuk është prezent, edhe kjo është detyrë e jona, ne u dashtë me raportue para Kuvendit. A e kemi krye ne detyrën si duhet? Jo. Edhe profa është këtu, prita mos po çohet me e kërkue këtë, që punë tonë ne që e kemi marrë përsipër, ne këtë duhet me e krye. S'kemi punë ne me ekzekutivin, ne s'un i detyrojmë ata çka punojnë, ne punët tona duhet t'i bëjmë. Ne lypim llogari e përgjegjësi prej tyre, nëse nuk pajtohemi – ne kemi pas raste kur ka qenë edhe Salimi – që kemi formue komisione për mbikëqyrje të punimeve në terren. Unë jam konë kryetar i Komisionit, kemi shkue në terren e kemi pa gjendje faktike, edhe kemi raportue para Kuvendit. Unë për Komisionin, po kërkoj në vazhdimësi që kjo punë me u krye. Ju duhet ta dini, mos lypni shumë llogari këta me na dhënë neve. Nëse duam, ne formojmë komisione edhe shkojmë i shohim në terren, edhe nuk ka nevojë me na dhënë ata përgjigje, ne qysh duam, ne përgjigjen e marrim vetë në terren. Gjysa e delegatëve s'janë prezentë këtu, për fat të keq. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Para se me e mbyllë seancën, deshta të sqaroj për opinionin publik që kryetari i Komunës ishte prezent në pikën eventuale, edhe pyetjet që ia parashtruat ju, iu përgjigj. Por, te replikat, ai e pat një arsye që doli. Faleminderit! E mbyllim këtë seancë!

Kryesuesja e Kuvendit

Arijeta Skeraj